


UDHËTIMI



HORA E ARBËRESHËVET
2000

*Progetto comunitario
“Skanderbeg 3000”*

*Ente proponente:
Comune di Piana degli Albanesi*

*Partenariato:
Unione Europea
Provincia regionale di Palermo
Comune di Palermo*

*Comitato scientifico:
F. Altimari (Direttore) - Università della Calabria
M. Mandalà - Università di Palermo
L. Melazzo - Università di Palermo
G. Ruffino - Università di Palermo
L. M. Savoia - Università di Firenze
A Di Sparti - Università di Palermo*

*Comitato tecnico:
M. Mandalà (Coordinatore) - Università di Palermo
G. Cuccia - Insegnante
V. Matranga - Università di Palermo
Th. Rrushi - Università di Tirana
G. Schirò Di Maggio - Docente
G. Schirò Di Modica - Insegnante*

*Illustrazioni:
M. Stassi*

*Coordinamento tecnico-organizzativo:
P. Manali - Direttore biblioteca “G. Schirò”*

La pubblicazione è stata realizzata con il sostegno di:



Commissione Europea



Provincia Regionale di Palermo



Comune di Palermo



Comune di Piana degli Albanesi

Le informazioni contenute nella presente pubblicazione non riflettono necessariamente la posizione o l'opinione della Commissione Europea

*Si ringraziano:
Comune di Contessa Entellina
Comune di Mezzojuso
Comune di Palazzo Adriano
Comune di S. Cristina Gela
Università di Palermo
Università della Calabria
Università di Firenze
Istituto Culturale Ladino
Scuola Media Statale “Dh. Kamarda” e Circolo didattico di Piana degli Albanesi*

* Udhëtimi

Udhëtimi. - Palermo : Comune di Piana degli Albanesi, 2000. - 240 pp. : ill. ; 29 cm - La pubblicazione è stata realizzata con il sostegno di: Commissione europea, Provincia regionale di Palermo, Comune di Palermo, Comune di Piana degli Albanesi.


1. LINGUA ALBANESE - Testi scolastici - Scuola dell'obbligo - Manuali - I. Comune di Piana degli Albanesi
491.991 ed. 20

Scheda catalografica a cura di V. Mansueto

“udhëtimi”




Abetari





asht




arrë




autobus





bar




bicycle





bun



c^ep






c^opë




çikërr




maçe




diell




derë




dardhë




dhi




dhjetë



dhëmbë



elefant





ëngjëll



ëmbëlsirë



ëndërr




fole




fshyesë



flutur



gërshetë



gozhdë



gërshëré

Gj


Gj





gjashtë



gjel




gjalpër



hekur





hënë






fik



indian





vajzë




kalli



kusi





libér



laps






lule



mollé





skollé




mur





mi



nuse





nëntë




një




shtenjë



ortodoks




pulë



patë




pishk





qëri




qepë






qelq




rosë



derë






rrugë




rrotë



rrush




semafor





shpi



shkallë




shportë





tetë



tryesë





televizor



unazë





ulli




thes




thikë





vajzé





ve




verë





nxënëse





xhilekun



xhilek




y||




zjarr



zogë



gozhde



buzhi

Hj

Mj



hje

hje



hjokë

“udhëtimi”



Pughare

Një djal i pabindur

Mbi tryesën e
shtruar janë
shumë shërbise. Djali
vëren pemët çë
janë te tajuri.



Djali merr
narënxën, e fsheh,
priet dhe ik.

I kundërt


Dhoni hap umbrelen...



...miku e mbyll.



Vajza hipet,
djali zbret?



Gruaja hyn brënda...



...burri del jashta.



Marieja shuan qiriun...



...e motra e ndez.

Te mjeshtja




Këtu gjëndemi te shpia e mjeshtjes.

Ajo ka në dorë metrin për të marrë mizurën një gruaje.




Pranë man pethkun ç'i duhet për vestën.

Me gërshërët pret pethkun.



Pastaj ulet, dhe me makinë
qep vestën.

Kur e veshura është e sosur,
mjeshtja i shkon hekurin.



Pylli



Në pyll janë
shumë drunj.



Dy druvarë me sopatat
presjën drurin



Mjeshtri i drurit, me
zdrukth e përpunon
për të bërë vunqe
për skollën.



Nxënësit janë ulur
të gëzuar në këto
vunqe.

Udhëthimi i letrës




Ky djalë shtie letrën
në kutin e postës.



Postini i merr të
gjitha letrat nga
kutia dhe i vë në
thes.

Letrat dërgohen me
autobus.



Nga posta, letrat i
shpërndan postini
në për horë.



Postini letrën ia jep
vajzës.

Djali me balonat



Ky njeri mban te
duart shumë balune
me ngjyra të
ndryshme.



Burri përpinqet me
një mik.



Ata flasjën njeri
me tjetrin.



Mendojën të hyjën
në bar.




Burri ngë mund të
hyjë në bar me
balune dhe ia jep
një djali.



Djali është i lehtë,
prandaj fluturon
bashkë me balunet.
Të dy burrat qëndrojnë
me sytë haptë.

Djali i lig




Një kalë rrjedh,



i zoti i qaset për
të i dhënë elbin.



Një djali i lig, me një
hekur shpon thesin.



Elbi zë fill të
derdhet pak e pak.



Elbi po derdhet.



Kali ngë mund të hajë
elbin çë ra te dheu.
Aty erdhi një pulë çë zuri
fill të hajë elbin
e kali qëndroi pa ngrënë.

Rrëfyeni ju














Rrëfyeni ju









“udhëtimi”



Gramatika

Pjesa e parë

I

Bukëza e Trinjës

Një bukëzë, lerë e rritur te gurët e Trinjës, po mahnitej tue parë shkëlqimin e ujit të liqenit më poshtë me hënën në qiell.



Një mbrëma shfaqja e pishqvet në ujë e tërroqi aq sa la strofkën e vet në Trinjë e vate bëri një të re buzë liqenit, nën drutë e pyllit të dendur.

Si sosi, u shtri te bari i lagët me bark përbys e ndenji atje gjithë natën tue bredhur me këlyshët e saj të shtrirë pranë te rëra o te pilet.

Një menatë, pas vitesh, gjegji një rrëmujë të madhe e pa një mizëri motopalësh në punë me lëvizje të shpejta.

Me drenë gjaku iu bë ujë e u fsheh njize nën dhe.



Në mbrëmje shpërthime të zjarrta e shurdhuese.

Hyri në strofkë e mosnjeri e pa më.



Mbiemri pronor

Shënim: Bukëza la strofkën *e vet* në Trinjë.
Mosnjeri e pa më *në strofkën e saj*.

Gjej fjalën e përshtatshme:

- * Bukëza u shtri te bari me këlyshët _____.
- * Këlyshët _____ luajtën pranë te rëra o te pilet.
- * Me lëvizjet _____ motopalët trëmbën edhe këlyshët

e saj
e vet
e tyre
e veta

Kujdes!

e tyre e vet m. sh.
 e veta f. sh.

Jatritë e vjetra

2

- Maçja më la një gërvishtje te dora !
- Lidhi një fletë ferri, - i thotë gjyshja.
- Një fletë ferri ? - pyen e mbesa e shton: - Drizat shpojën !
- Kur ë hera e mënëzvet, - i priret plaka tue qeshur, - glëmbavet ng'i trëmbe...vërtet?

Kur isha vajzë jatronjtë na shërojën nga sëmundjet po me barëra, gjethë e rrenjë. Hyrë brënda e shih te gramari im: atje gjen onxarë, dhafnë, splitër, ashprele, mëllagë, skort, gurthyes...Ca shërbejën për anën e jashtme e ca mirren për grykë o me hundë. Barërat e njoma e të thata janë të mirë për të sëmurët e zëmbrës, të mëlcisë, të lëkurës, të shprethkës, të mushkërivet e të veshkavet. Bën mirë edhe përsheshi, freskimi i lopatës kur ke dhëmbje dhëmbësh, nxite e ragadë.

Sot vajza ime, mirren tisanet te erboristi vetëm për modë, u i mora si jatri kur isha e vogël e më ndihën. "Ziej këto fletë, - na përshkruaj jatri, - pi këta lëngje, shtrydh këto pemë, ha këto valeza, mirr..."

Ilenia del jashtë, merr një fletë ferri e, pa thënë më gjë, e ngjin mbi gërvishtjen.



Mbiemri dëftor

Shënim:

m. shumës Këta barëra rriten te malet.
 Era e këtyre splitrave ndihet nga larg.
 Këtyre lëngjeve u duhet ca kripë.
 Këta përsheshe zihen mirë te poçja.
 Rreth këtyre lëngjeve dimë pak.

Ushtrime:

f. shumës: këto, i-e këtyre, këtyre, këto, këtyre
 _____ valeza janë aguridhe.
 Rrembi i _____ pemëve ë i degëzuar.
 _____ dhafnave iu thajtën gjethet.
 _____ kumbulla i ha me ëndje të madhe.
 Mes _____ degëve gjeta një fole.

3

Dimri në Horë

Bie shi, po bie borë,
floqe floqe bie me erë.
Në mal lidhi te ca herë
e rrimë të gjithë në derë
si fëmijë dorë më dorë.
Sa e ftohtë ë kjo Horë !
Bie shi, po bie borë,
floqe floqe bie me erë.



Mbiemra të pacaktuar e pyetës

Shënim

* ca herë


* sa ditë?

Ushtrim

* _____ herë ?

* prita ____ ditë.

* ndenja në shtrat për ____ mot.





Shpia ime ë e vogël, kemi dy shtretra, një dritare e një maçë. Te shpia ime hamë po mbrëmënët, kur tata mbjidhet nga përjashta me ndonjë perime vjeshtore aguridhe e ndonjë pemë te trasta. Jemi të

vapkëth.

Ujët te
kudhi na
vaket po
ngë na prier kurrë valë.

Tata ka sy të kaltër, mëma ka sy të kaltër, u kam sy
të kaltër e maçja ka sy të kaltër.

Kur jemi të gjithë rrëth tryesës, shpia jonë duket një
qiell plot me yj.




Mbiemri pronor

Shënim

* Mëma ime ka sy të kaltër.

Ushtrim

- * Tata _____ ka sy të kaltër.
- * Mëmat _____ kanë sy të kaltër
- * Motrat _____ kanë sy të kaltër



	JO
im - ime	të mua
yt - jote	të tij
i/e tij - i/e saj	të tij/saj
ynë - jonë	të neve
juaj	të juve
i/e tyre	të tyre

5

Shkrepje pa dëm



Një krimb u nglat butë të grij një fletë lakre. Te një luce, ndër marrvasha e hamule, pa një brethk e tha:

- Prit ca herë e të përcjell !

Një rosë e egër pa brethkun e hapi cepin të... E qëndroi një gjuetar prapa një shkëmbi me shkrepjen e skupetës së tij po pa dëm pér njeri: zoga fluturoi, brethku u fsheh nën ujë e krimbi pak e pak sosi të grij fletën e lakra.

Përemra e mbiemra të pacaktuar

Gjej lidhjet ndër pjesët:

- | | | | |
|----------------------------|------|----------------------------|--------|
| <input type="checkbox"/> 1 | ca | <input type="checkbox"/> | disave |
| <input type="checkbox"/> 2 | cave | <input type="checkbox"/> 1 | disa |

Ushtrim

- _____ u lypset puna në Horë.
- Përcolla _____ mish me asht.
- Miqtë vanë: _____ u fala, të tjerve jo.
- _____ vetë më folën mirë pér tij.
- Liejta _____ dyer me vaj.

LOJË




Urtësi... në liri

6

Lidh pjesët e fjalive përkatëse:

- | | | | |
|----------------------------|--------------------------------|----------------------------|-------------------------|
| <input type="checkbox"/> 1 | Mirë u gjënd | <input type="checkbox"/> | ka ve. |
| <input type="checkbox"/> 2 | Kush ha bukë | <input type="checkbox"/> 4 | ku vete gjen mushkonja. |
| <input type="checkbox"/> 3 | Kush ka pula | <input type="checkbox"/> | kush mirë u rua. |
| <input type="checkbox"/> 4 | Kush rri me zonja | <input type="checkbox"/> 2 | bën drudhe. |
| <input type="checkbox"/> 5 | Kush bën drutë te dhromi i lig | <input type="checkbox"/> | ha likënkë. |
| <input type="checkbox"/> 6 | Kush zien llapsana | <input type="checkbox"/> | i nxier mbi krahë |



Përemri lidhor


Kush ë maçë, zë mi.

Ushtrim

_____ ka pula, ka ve.

I jap nder _____ më nderon mua.

Nderonj _____ më nderon



7

Hora

O e bukura More !
 Si të lashë e më ngë të pashë!
 Atje kam u zonjën mëmë,
 Atje kam u zotin tatë,
 Atje kam edhe tim vëlla.
 Si të lashë e më ngë të pashë !

- Vjet, - tha lalë Bua, - te kalivet anë malit të pelavet tëtimt na hyri te eshtrat si te briu i kaut.

- Riejtëm shirat më se zborën, - shtoi la Gj. Burrleshi. - Ndenjëm gjithë moin mars pa dalë jashtë, kujtone ?

Todhari i Dragotës e Gj. Golemi, si pleq të urtë, thanë se duhen shpi guri me themele të forta.

Arbëria jonë sot është bota ku ndodhemi me gra e fëmijë domosdo. Në botën e huaj ruhen po kujtimet.

- Ku mendoni se është më mirë të stiset fshati ynë i ri ? - u pyeji të dyve la Ntoni Toja, një burrë i hollë si filil.

- Te një vend, - thanë ata, - ku buron ujë, ku fryn më pak era, ku bryma në të gdhirë na lag më pak këmbët e ku rrinë larg mushkonjat.

- Farefisi im, - tha Papa Jani Kaminiti prej Himarës, - stis pjesën e tij te shkëmbi.

- Farefisi im, - tha lalë Bua, - e stis përposh Brinjës.

- Farefisi im, - tha i sprasmi, - e stis ndër fusha e rehje.

Një trikëndësh. E me thelimën e Monrealit u shtunë themelet e të parave shpi të Horës. Ish viti 1488.



Përemri vëtor

Shënim:

Shpinë e trashëgova nga mëma.


Shpitë i trashëguam nga tata.

Ushtrim:

Dherat ne ___ patëm nga Monreali

Farefisi im pjesën e tij ___ stis te Brinja.

Farefisi im shpitë ___ stis te Shkëmbi.



Tata im

8



Tata im punon në zyrë e mbjidhet brënda ngost tue ndenjur për orë përpara kompiuterit.

Më se gjithë i lodhen sytë e mbrëmënët në television sheh vetëm programe ku flitet për sport, natyrë e dokumentare.

Pas meje te shtrati ngulet ai: më bën rrivethkën te pethkat, pret ca herë e shuan dritën.

Mëma në kuçinë lan e shplan tajurë, thikë, lugë, kudhe...




Kjo detyrë ë e saja, po tata thotë se i nget edhe atij.

Përemri pronor

Shënim:

Kjo detyrë ë *e saja*

Ushtrim:



* m. (timt / tat)

9


Festa e mëmës

Në lulishten [] Afërdita mbjodhi një tufë lulesh për të jëmën: [] e verdhë, [] të bardha, vetëm [] e kuqe.

Ajo [] pranoi me hare, puthi të bijën dhe [] haristisi me [] fjalë:
-Kjo ë ditë lumturie për [] se [] kujtove. Faleminderit, bija [] !



Çdo fjalëz te vendi i saj:



bija *ime* / *ime* bijë

po

Faleminderit, bija *ime*.



Plakarushja e Honit

10



Thuhet se te Honi del një plakarushe.

Ajo, kur ngryset, ngijipet te mali i Kumetës me një shkallë druri, çel një hërnar në majë, nxier boshtin nga bunaka e tjerr lesh gjithë natën.

Më para se të gdihet, lëshohet poshtë me perin të endur e, tue ecur në lumin Trinjë, vete sos te harambujt e Honit ku fshihet gjer në mbrëmje.

Shtu prej shekujsh !

Kur ish kopile lëshohej me një tërkuzë te Honi i Krujës, ku trimi i saj ruaj kështjellën e Skënderbeut. Pas vdekjes së Heroit ajo erdhi te Hora me të shoqin e la gjithnjeri atje në mbrojtje të Krujës. Të bijvet u tha:

- Ejani pas nesh ku shihni dritë hërnari në majë të malevet.

Një menatë te këmbët e shkallës së thënë gjetën cariqet e saj e jo më gjë.

Mbi malin panë edhe një shqiponjë me një gjalpër në thundre.

U tha se vdiq me dhëmbjen therëse çë ndiejti kur xuri se Mahomi i vau të bijtë.

Ai hërnar ndizet çdo natë gjer më sot, po vetëm ca vetë e kanë parë ndër rrufe e gjëma.

Përemri vtor

Në kontekstin e tregimit shëno përemrin përgjegjës:

		kujt			kë	
	atij	asaj	atyre	atë	ata	ato
u tha bijve			x			
i vau të bijtë						
ca vetë i kanë parë						

||

Ketërthi

Një mënataë ketërthi u zgjua me dridhma e pa se lisi e arra pranë ishin pa fle^{*}.

C'pa te pylli ?

Rrushqe , shtenza , ftonj , arra **të butarme**, valeza **të murme**.

E në quell ? Mjegulla e të dendura. Ndonjë .

Mbjodhi gjithë lëndrat çë gjeti përposh lisit e bëri fole të dimrit.




Mbiemri cilësor

Gjej për çdo mbiemër vendin e tij:



Ndih ketërthin të gjenjë lëndrën.



Sinonime: * dridhma, rrëqethë

Kush e gjeti

12

Ca fëmijë vihen në rreth. Njëri prej tyre, në qendër, bën pyejtje kujtdo. Kur një lojtar thotë “e gjeta u”, çdo kafshë rrjedh në strofkën e vet (vende të njojur) të mos jetë marrë.

Në gjuetari qëndron pa gjah, ë zëvendësuar nga lojtari çë tha “e gjeta u”.

L O J A

A - Kush e gjeti bishtin e ljeprit ?

B - Bishtin e ljeprit e gjeti një dhelpër.

A - Kush e gjeti bishtin e dhelprës ?

C - Bishtin e dhelprës e gjeti një qen.



A - Kush e gjeti bishtin e qenit ?

D - Bishtin e qenit e gjeta u.

vizato qenin

e

ljeprin



Përemri vtor

Shëno përemrin përgjegjës:

	kë		kujt	
	ata	ato	atij	asaj
i gjeti jashtë				
i zuri bishtin				

13

Një gjyshe arbëreshë

E glatë pritja.

Përgjigjet nani i ke të gjitha
po t'u mbi goja.

Në Gjermani
pas hapavet të djalit tim
të vogël je hje,
si një herë e vëtmja je ç'e ndjek në punë
e ruan.

Kur piret djali në shtëpi ?

Ti e di.

Si rrinë fëmijët e të madhit
prej muajsh ngëna pyen më e ke
sigurisht
për shërimin e tyre
nga sëmundjet
porosi të përshtatshme.
I ke e ngë flet më.



Mbiemri pronor

Shënim:

- për shërimin e *tyre*

F

M

Ushtrim:

- për shërimin

F

M

e tij
e saj

Çapelet e Drangoit

14



Pleqtë rrëfyejën (e gojëdhënët e vërtetë) se nën çapelet e Drangoit fshihej një pulë me ca zogj të artë në furrik: mëmë e bij me atë pamje ?

Gratë po shtijën onie mos i vejën fëmijët atje.

Një kanosje për të gjithë e veçanërisht për më të gjallët.

Ato çapele, një e madhe mbi një e vogël, për Drangoin ishën një pikë vrojtimi nga sulmet e Kuçedrës gjaktare. Një mbrëma e pa në gjumë, mori heshtën e fshehur te Gropat e Shën Gjergjit e, me atë në duar u lëshua në mbrojtje të vendit. Një sahat më para çapelet ranë të gjitha e bota i thithi te një gropë e humbët e humbët.

Çapat e sheshta (çapele për Drangoin se për ne zvogëlimi ë jashtë mundësivët tonë) sot mbijetojën vetëm te kujtimi i pleqvet.



Mbiemri dëftor

Shënim:

Ato çapele janë të sheshta.

Pamja e atyre çapeleve më tërheq.

Atyre çapeleve u trëmben gjithë.

Ato çapele i pashë kur isha i vogël.

Prej atyre çapeleve dukej pjesa e poshtme e Horës.

Ushtrime:

m. shumës: *ata / i-e atyre / atyre / ata / atyre*

_____ gurë janë të sheshtë.

Pamja e _____ gurëve më tërheq.

_____ gurëve u trëmben gjithë.

_____ gurë i pashë kur isha i vogël.

Prej _____ gurëve dukej pjesa e poshtme e Horës



15

Thashë si the

U thashë si the ti,
 ti the si thashë u.
 Kush e tha, thamë tē dy.
 Thuaje ti si e thash'u.



zglidhgluhë


Përemri pyetës

Shënim:

Thamë *kush* e tha.

Ushtrim:

Thuajmë me _____ vete e tē thom _____ je.



A - Krahasimet e mizës



- Glishtja ë më e madhe se glishti.
- Mëni i zi ë më pak i ëmbël se ai i bardhë.
- Delja ë (...) e butë sa dhia.

B - Krahasimet e rriqërës

- Lopatëza në ujë lëvrin më se shëshënja.
- Delja ha më pak se lopa.
- Në teatër djemtë paguajën sa vajzat.



C - Krahasimet e gërtëhjes



- Një nxënës shkruajti më shumë se sa i lypi mësuesi.
- I urti thotë më pak se sa di.
- Shpia nxën (...) sa do i zoti.

Ç - Krahasimet e krimbit

- Fleta e dardhës ë më e glatë se e gjerë (gjatore).
- Fleta e urdhrit ë më pak e glatë se e gjerë (e përmbyset).
- Shpia ime ë aq e vogël sa e bukur.




D - Krahasimet e kërmillit

- Hora ë më i madhi katund i Arbërisë.
- Nusja ime ë shumë e bukur.

Shkalla krahasore

- 1 - Maçja ë _____ e egër ____ qeni.
- 2 - Vishnjet janë _____ të ëmbla ____ kërshtitë.
- 3 - Lulet janë () të bukura ____ fluturat.



17

Pleqtë e papagali folës

Dy pleq, të mos rrijën vetëm brënda, blenë një papagal. Një shpi ku dhe muret flëjën. Për vite po ndonjë fjalë kur hajën, te tryesa si për një ndeshje me ping-pong :

- Ëm bukën, shkomë ujët, thikën, lugën, vrukën ...

Një ditë dimri, ndërsa ngroheshin anë zjarrit, u ndie një zë pa i gjegjur më para. Pleqtë u trëmbën, po përqark mosgjë lëvizej. Pas ditësh u ndie pometa :

- Shkomë ujët ...

Her'e herë njeri i shkoi një thele bukë tjetrit pa lypur e pak e pak burrë e grua u burën qen e maçë.

Një menatë papagali u nGRE njize e u foli hapët të zotravet.

- Goja duhet t'i shërbënë gojës, - tha me dënesë. U flas mirë arbërisht e dua t'ua mësonj gjithë atyre çë më paguajën. Jini maçë e qen përmua e ju lë në paqe se më kini bërë të mirë.

Fluturoi e vate te Gjoni, një përrua çë ndan Horën ndysh.

Natën një zë i përvajshëm, ai i Gjonit. U qas e i tha:

- E do mësuar gluhen arbëreshe ?

Gjoni hapi cepin, e shpoi te qirka e vate mbatanë përroit. E pritën keq edhe karraxhani, kolbi, kryerina, pula ... të gjithë !

Në fund, mbi një hu, e pa një klaun (*kloon*), po atij iu muar goja për jetë.

- Ë, - tha burri, - ky papagal më duhet te puna se ë pa zë.

E mori me vete, dhe e pagëzoi me një emër të ri: *krubeç*.

Një sfidë për të gjithë.



Mbiemri dëftor

Shënimë:

Ai qen i leh hijevet.

Gruaja e atij burri ë e bukur.

Atij gjeli i ranë pendët.

Atë vit ra borë për një muaj.

Prej *atij* dimri bora lidh po te malet.

Ushtrime:

F - njëjës: *ajo / i - e asaj / asaj / atë / asaj.*

_____ dhelpër i leh hijevet.

Burri _____ gruaje ë i shëmtuan.

_____ pule i ranë pendët.

_____ herë ra borë po te malet.

Prej _____ vere vete te dejti me miqtë më të ngushtë.

Te Ghruta e Gharrunit

18

- Kujdes, nxënës tē dashur: jemi te Ghruta e Gharrunit ! Këtu rritet rriciteli, një bar oficinal çé i glet kakacidhes. Kjo éshtë e para dhomë. Hyjäm dal'e dalë, një nga një. Hapni sytë e vreni ku vëni këmbët: ky ngë ë vend pér tē ngathët. Miku me mikun. Më para se tē vemi poshtë, me dritën e ditës, shihni bukuritë e ambientit: pika e ujit grisi e përpunoj gurin me mjeshtëri tē pakrahasueshme. Vreni mirë sa figura nxori natyra prej gurit ! Artisti çé gdhend gurin, po mëson nga natyra. Mos shkini te hjima. Shkojëm tek e dyta gropë njeri pas tjetrit me radhë. Presjäm ca herë mos na mirren sytë, pra shkojëm tek e sprasmja.

- E bukur! - thotë një nxënës në tē errët e me zë tē ngjurrët. - Këtë gropë tē nëntëshme e përshkon një rrip uji tē pastër, një pasqyrë plot lëvizje.

- Ky éshtë një shamull - thotë më i vogli i grupit e shokët shpérthejën tē qeshuri.
- O - shton një tjetër - e atje brënda pashë një brontosaur!



Përemra e mbiemra dëftorë

- Shënime:

- Kjo éshtë hyrja e shpellës.
- Gryka e kësaj shpelle ë e ngushtë.
- Kësaj shpelle iu dha emri i një kusari.
- Këtë humbore e hapi ujët.
- Prej kësaj thyerjeje vehet në tē sprasmen.

- Ushtrime:

M. njëjës: *ky / i-e këtij / këtij / këtë (të) / këtij.*

- _____ ë një vend i bukur.
- Hyrja e _____ vendi ë e ngushtë.
- _____ vendi iu dha emri i një kusari.
- Në _____ vend erdha me miqtë.
- Prej _____ vendi duket gjithë Saravuli.

19

Zë skolla

Në shtator ajri i larë nga të parët shira të vjeshtës hyn i ëmbël te hundët e njeriut e i jep frymë.

Herët vo Lena, dyer hapur, me hapa maçje qaset te shtrati i së bijës, zogë te foleja, e me dorë përkëdhelëse e tund:

- Ilenia, e mira ime, ngreu: sot zë skolla. Ç'të duhet e ke te trasta: libre, fletore, pendë. Mos u mëno, ë!

Vajza hap sytë e, sa ka ç't'e thom, vishet, mbath këpucët, lahet, krihet e del jashtë.

- Mos lyhesh me ingë, ki kujdes, ruaju nga rrugaçët - janë të sprasmet fjalë të së jëmës nga dritarja. Zëri i saj i qëndron te veshët për një copë herë. Skolla e Ilënës ndodhet te Guri i Mas Marës, pak jashtë Horës.

Dhromit asaj i shkon për krei një luzmë mendimesh. Gryka e Honit u qep me Kumetën e era, në udhën 8 Mars, po bredh hijshëm me gjethet e verdha e të kuqarreme përdhe.

- Kush e di kë do të shoh sot ndër miket e vjetme! Çilat do të jenë të rejat?

Pyetje të ligjshme. Në fakt njeh për të parën herë miken Alesia, vajzë e thjeshtë, e butë, e pastër si ujët e lumevet tanë një herë, para ndotjes së sotme.



Përemri pyetës

- Shënime:

- *Kush* e mori lugën time?
- *E kujt* ë thika mbi tryesë?
- *Kujt* ia dhe tajurin me mish?
- *Kë* le pa ngrënë?

- *Thuaj* _____ e mori lugën time.
- *Pyej* _____ ë thika mbi tryezë.
- *Shih* _____ ia dhe tajurin me mish.
- *Kujto* _____ le pa ngrënë.

- *Kë* do për shok?
- *Çili* prej jush flet i pari?
- *Çili* nxënës i mësoi mirë pronorët pyetës?
- *Çili* ë malë më i lartë i Horës?

njëjës: *çila / i-e çilës / çilës / çilën / çilës*
 F shumës: *çilat / i-e çilavet / çilavet / çilat / çilavet*
 emër: *nxënëse / nxënëse / nxënëse / nxënëse / nxënëse*

Ushtrime:

- M: njëjës: *çili / i-e çilit / çilit / çilim / çilit*
 shumës: *çilët / i-e çilëvet / çilëvet / çilët / çilëvet*
- _____ nga ata ë me ne?
 - _____ prej miqvet i dërgove të falat?
 - _____ ndër ata njeh ti, vëllau im?
 - _____ te qentë ngë lehjën?
 - _____ veç nesh i dhe të rejat e ditës?

Buka thele thele

20



zglidhgluhë

Shprehje



Ushtrim:

Kush në të thënën e mësipërme

ë përemër lidhor
 pyetës

21

Gjëra e çilësi të tyre

Një mësuese vate përjashta me nxënësit e vet e i ndajti në dy grupe (djem e vajza) me një dëtyrë nga një.


- Kjo - u tha atyre- s'është thjesht një shëtitje në fushë po një stërvitje skollore. Ju djem kujtoni ç'gjëra shihni e ju vajza çilësitë e tyre.

Përbledhja ë ë në tabelë:

Ç'panë djemtë	Çilësitë çë u dhanë vajzat
1 një përrua	1 i thatë
2 ca shpi	2 të vjetra
3 ca dele	3 të qethura
4 një mëz	4 i vogël
5 ca shegë	5 vjeshtore
6 ca valeza	6 aguridhe
7 një hon	7 i humbët
8 një lopë	8 shterpë

Mbiemri cilësor

Çdo emri një çilësi:



Polic bashkie

22

M'i forti te kjo Horë
qëndron gjinden me një dorë.

E qëndron po me një glisht,
ë arbëresh e flet litisht.

Në e sheh ti m'e thua
se të qëndron me një thua.

Kudo je, ke sa i fale
mos të shkruanë dy verbale.



Gjej përemrat çë të duhen në fjalitë më poshtë:

S	U	K	U	J	T	D	O	R	Ë
A	M	E	R	I	K	Ë	D	O	C
M	I	K	U	S	H	D	O	S	Ë

1 - i flet _____

2 - rri me _____

3 - le të vinjë _____

23


Ndërrime vendi dhe...



- mëma *e mirë* → *e mira* mëmë
- hera *e parë* → *e para* herë
- mali *i lartë* → *i larti* mal
- plaku *i shkretë* → *i shkreti* plak
- dita *e sprasme* → *e sprasmja* ditë

Mbiemri çilësor

Një peng kujt del jashtë normës



- lumi i gjerë → *i gjeri lumë*
- pula piklore ←
- motra e dashur → _____
- valeza vjeshtore ←
- lopa e rëndë → _____
- derri i majmë → _____
- dega e njomë → _____
- honi i humbët → _____
- dru të trasha ←
- papagal folës ←
- kumbull gjatore ←



Maçja prej plastike

24

Ca mi tē aravet panë një maçe me një zile në qafë e pér një javë u fshehën thellë në gropat pa dalë më.


M'i vogli i tē gjithëve pati guxim e qëndroi jashtë.

- _____ del, vjel - tha.

Një mbrëma u qas pranë maçes, jo m'e madhe se një thua, e pa se ish prej plastike.


- _____ vërtet ë një rrezik - tha - se plastika me ndotjen e ambientit na vret edhe ne !

Zërin _____ e shpalli era e gjithë e gjegjën, po mosnjeri di se një fëmijë klajti një natë tē tërë, kur përjashta ngë gjeti më maçen prej plastike çë la përposh këpurdhavet tē kukutës.



Përemra e mbiemra tē ndryshëm

Çdo fjalëz në vendin e saj në teskt



25

Igli

Igli, si gjithë të tjerët, për arbëreshët e Horës ë një i huaj, mirse prindrat e tij janë shqiptarë e flasjën në përgjithësi gluhen tënë.

Ai, në të vërtetë, flet arbërisht e jo më shqipen e sotme.

Në skollë e dinë gjithë se ngë leu te Hora, po Igli ngë ndihet i huaj e na thotë të gjithëve se jemi degë e të njëjtit lis, farë ilire, mirse të shpërndarë.




Shënim:

- vdesjëm të gjithë
- Shqipëria ë atdheu i të gjithëve
- u fala të gjithëve
- zëhet me të gjithë

Ushtrim:

- Gruaja e mirë kujdeset për _____ bijtë.
- U fola _____ motravet.
- Im vëlla grindet me _____.



Milingonat

26

Dy milingona gjetën mes aravet një koqe drithi çë një harabel shkoqi te një kalli e la mënjanë.

- E imja ! - tha m'e vogla.
- Jotja ? E pashë u më para - tha tjetra tue shtrënguar farën në gojë.

E mori e dal'e dalë me mundime të pathëna, e hyri brënda folesë.

Një mizë, s'dihet çila, i rrëfyejti gjënë Zonjës së milingonavet e mbrëmanet:

- Ne milingonat - tha ajo - rrojëm në shoqëri e bashkimi na jep fuqi se jemi ndutu të vogla. Na duhet ndihma, jo grindjet. Ndër ne pasuria ë e të gjithave, jo imja, jotja, e saja, e tija, jona, juaja, e tyre

...



Përemra e mbiemra pronorë

F	Veta e parë	imja	i/e simes	simes	timen	simes
njëjës	Veta e dytë	jotja	i/e sates	sates	tënden	sates

Ushtrime:

- A 1. Maçja ime e _____ janë të zeza.
 2. Këlyshët e maçes sime e të _____ janë të vegjël.
 3. Maçes sime e _____ i ra qimja.
 4. Maçen time e _____ rrugaçët i morën me gurë.
 5. Folëm rreth maçes sime e rreth _____.

- B 1. Qeni im e _____ janë të bardhë.
 2. Këlyshët e qenit tim e të _____ janë të vegjël.
 3. Qenit tim e _____ u ra qimja.
 4. Qenin tim e _____ rrugaçët i morën me gurë.
 5. Folëm rreth qenit tim e rreth _____.

B.1 - yti B.2 - tëndit B.3 - tëndit B.4 - tëndin B.5 - tëndit

27

Në ditën e emrit

Në ditën e emrit të saj Ilenia ghris në shpi gjithë miket. Ca janë gjitona, ca të tjera shoqë të skollës. Vetëm Alesia ë e huaj.

- Kjo ë një mike ime e huaj - i thotë prindëravet.

E asaj :

- Mëma ime, ime motër, im vëlla, motrëmëma, im ungël me nusen, gjyshja nga ana e mëmës e ajo atërore.

Alesia haristik për nderin e i jep dhuratën mikes tue thënë:

- Urime me gjithë zëmbër !

Tryesa me të ëmbla ë shtruar e miket qasen të hanë: kush merr një të ëmbël e kush një tjetër. Djemtë i bien te veglat muzikore me pëlgim të madh. Ca veta flasjën për skollën, ca kërcejën me gëzim e gaze.

Një mbrëmje e paharrueshme !

Mbiemra pronorë përpara emrave me lidhje familjare

Shënim

njëjës	veta e	M	im bir	i/e tim biri	tim biri	tim bir	tim biri
	parë	F	ime bijë	i/e sime bije	sime bije	time bijë	sime bije

Ushtrime

njëjës	veta	M	yt	i/e tët	tët	tët	tët
	e dytë	F	jot	i/e sat	sat	tët	sat

- I dërgova të falat _____ motre e _____ nipi.
- U pashë me _____ ëmë e me _____ motër.
- I fola _____ emte e _____ ungli.
- Urime për tij e për _____ mbesë.
- Mora letrën e _____ kunati.
- Ndenja gjithë ditën me _____ at e me _____ njerkë.

Shprehje :

*Urime të ngrohta,
të nxehta, të përzemërtë.*

Fjalë :

i/e ëmbël
i/e hidhur

Kush jam u ?

28

Një fëmijë i pyen prindravet:

- Kush jam u për ju ?
 - Ti je djali ynë i vogël.
 - Kush jam u për tij ? - i pyen së motrës.
 - Ti je im vëlla.
 - Kush jam u për Zotrote ? - i pyen gjyshes amtare.
 - Ti je im nip, djali i sime bijë.
 - Kush jam u për Zotrote ? - i pyen gjyshit atëror.
 - Ti je im nip, djali i tim biri, e jot motër ë ime mbesë.
 - Kush jam u për tij ? - i pyen Luanës.
 - Ti je im kushëri, bir i motrëmëmës e i lalbukrit.
 - Kush jam u për tij ? - i pyen Niqes.
 - Ne jemi kushërinj.
 - Kush jam u për Zotrote ? - i pyen la Masit.
 - Ne jemi gjëri.
 - Kush jam u për Zotrote ? - i pyen la Gjergjit.
 - Ne jemi krushq e gjitonë.

Vërtet të degëzuara janë lidhjet e gjakut.

Mbiemri pronor

Shënime

Shprehje

Gjtonia, gjëria

<p><i>përpara e pas emrave</i></p>	<p><i>vetëm prapa</i></p>
<p><i>me lidhje familjare</i></p>	
<p>im atë tata im</p>	<p>mëma ime</p>
<p>ime motër motra ime</p>	<p>gjëria ime</p>
<p>ime mbesë mbesa ime</p>	<p>krushku im</p>

Mbiemra pronorë përpara e prapa emrit:

motér	vëlla	vjehërr	at	kushëri	nip	mbesë	shoqe
bir/bijë	dhëndër	re	kunat	kunatë	njerk	njerkë	ungël

Ushtrime:

im/ime

A decorative element consisting of a vertical red border with horizontal red bars extending across its width at regular intervals.

motér
njerkë
mëma
burri
vajza
vëlla
bijë
familja

motra
njerka
gjitoria
djali
gjëria
vëllai
bija
mbesa

29

shkalla
e →
krahasimevet

1

2

Dhia ë e butë sa delja
SHKO TE DELJA

3



LOJË ME ZARE



4

8

I urti thotë më pak se sa di.
PRIRU PRAPA PESË TË NDARA E MENDO

7

6



5

Lopatëza n'ujë lëvrin më se shëshënja
QËNDRO NJË HERË E LE TË SHKONJË LOPA

9

Hora ë m'i madhi
Katund i Arbërisë
EC PËRPARA TE SHQIPONJA

10

11

12

13

14



18



17

16

EC MË TUTJE TE ZOGAT

15



19




← **MUNDE QËNDRO**



Ç' do Afërdita ?

30



Afërdita do :

- 1 një (nie)
- 2 një (gjel)
- 3 një (patë)
- 4 një (pallua)
- 5 një (rosë)
- 6 një (pulë)

Numërori

Ushtrim:

- Sa pula do Afërdita ? - Një.




31

Akrostik

KY ————— KËTA

KJO ————— KËTO

Gjej fjalët e përshtatshme:



1 - Kjo ë gjizë

2 - ____ ë ____

3 - ____ ë ____

4 - ____ ë ____

5 - ____ ë një ____

6 - ____ ë ____

5 - ____ ë një ____

8 - ____ ë një ____

9 - ____ ë një ____

Përemra dëftorë

- 1.1 - Ky ë një vidh.
 1.2 - Këta janë ca vidhe.
 2.1 - ____ ë një ilk.
 2.2 - ____ janë ca ilqe.
 3.1 - ____ ë një rrap.
 3.2 - ____ janë ca rrape.

- 4.1 - ____ ë një plep.
 4.2 - ____ janë ca plepe.
 5.1 - ____ ë një lis.
 5.2 - ____ janë ca lise.

Rrici fatlum

32

Fletët e druvet në pyll po bien pér
dhe e rrici fatlum i shkalis tē gjenjë tē
sprasmet frute pér dimrin që qaset.

Bën tētim ! - thotë me dridhma. Ë
hera tē vë mënjanë tē ngrënët pér dimrin
më para se tē bie në gjumë brënda folesë.

Papritur nga një pemë ndahet një mollë e i ngulet te një thumb.


- Pa vre: ra një mollë nga pema!

Më tutje nga një degë tjeter i bie një mollë m'e madhe se ajo e para.

- Një mollë tjeter ! - thotë me gëzim tē madh.

E merr me këmbë e me atë mbyll hyrjen e folesë tue marrë gjumë.

Ende sot flë e pret motin e mirë.



Përemra e mbiemra pronorë

Shënim

Era shkundi një mollë nga dega e saj.

Ushtrim

Një vajzë u nda nga familja _____.

Familja ime është _____



33

Pritje

Pres në shpi një mik me të çilin u njoha vjet në det. Vjen nga Shën Vasili çë ë një katund arbëresh si yni në Italinë jugore.


Kur u pamë e para herë, më se me gojë folëm me zëmbër e jemi si vëllezër. Thashë: “Ky ë djali, nga i çili s’dua më të ndahem për jetë”.

Sonte, njëj me miqtë, të cilëvet po u flas për atë, e pres te shpia ime me padurim. Dua të shkojëm një mbrëmje në festë.

Përemri lidhor

Ushtrim

- Ndero familjen me _____ u lidhe me miqësi.
- Pres mikun me _____ u njoha vjet.
- Miqtë, _____ i fola për ardhjen tënde, janë në pritje te shpia ime.



Puna natën

34

Jo gjithë punojën ditën.

Në tretësorin e në tregti ca shërbime bëhen natën: te spitajet, aeroportet, stacionet...

Pa ndërprerje. Shtu mbylllet dymijëvjeçari !

Te Hora, kur gjithë flënë, një jatrua rri në shërbim e në ndihmë të gjindes.

Një shërbim i detyrueshëm për bashkësinë e tërë !

Domosdo natën punojën edhe furrnarët, se të ngrohtët i mundon më pak e se buka ardhet me mirë. Te shitësit, më para se gjithë, blihet buka. Her' e herë gratë harrojnë ndogjë tjetër, po bukën kurrë.

Buka, me pak fjalë, ë më e mira e gjëratet të përditshme.

Shkallët e mbiemrit

- Buka ë m'e mirë se mëlmesa.
- Mëlmesa ë më pak e mirë se buka.
- Buka ë () e mirë sa mëlmesa.
- Buka ë më e mira e gjëratet.
- Buka ë ndutu e mirë.

Ushtrim

Çdo fjali te vendi i saj

Krahasim një me një
-Buka ë m'e mirë se mëlmesa

Krahasim me epërsi absolute
- Buka ë ndutu e mirë

Krahasim një me ca

35


Pul'e bardhë e pul'e zezë

Në mbrëmjet e fjellëta të dimrit çiljëm, me dru të njoma e të holla, zjarrin në cep të rrugëvet e, kur era na shtyj tymin te sytë, e largojëm me fjalët pajtuese “pul'e bardhë eja këtej, pul'e zezë ec atej”.

Kur flaka zbutej, rrathi i djemvet ngushtonej e zëjën rrëfymet, pullaret.

Pak e pak qëndroj po hiri e ndo urë.

Të sprasmit vendin ia lëjëm maçevet. Edhe ato ngroheshin pas nesh tue pritur mitë.




Përemri vtor

Shënime

- 1.1 - T'e dha glishtjen ime mbesë ?
- 1.2 - M'e dha glishtjen jot mbesë.
- 2.1 - Ju e dha librin im nip ?
- 2.2 - Na e dha librin yt nip.

Ushtrime

- 1.1 - _____ dha glishtjet ime mbesë ?
- 1.2 - _____ dha glishtjet jot mbesë.
- 2.1 - _____ dha libret im nip ?
- 2.2 - _____ dha libret yt nip.



E sprasmja e vitit

36

Ë e sprasmja e vitit e vo Mara pret gjinde në shpi.

- Sonte - i kujton së bijës - luhet tumbulla, mirre ku ë e mos harro një grusht drithi. Ë ngrysët, gjëmon, drita po shuhet e jashtë bien floqe.

- Poshtë ngë vete - thotë vajza e trëmbur. - Në vend të drithit vëmë sumba, ë paraç. Merr gëershëren e te dy minute shkul gjithë sumbat e çerrit të një xhipuni të grisur.

- Te sunduqi - shton ajo - e ha po kopica.

Pak më vonë gjyshja shkalis te sunduqi e ngë gjen gjë.

- Ku sosi xhipuni im - pyen plaka - xhipuni i pajës, i kujtimevet, ku sosi ? Mjera u ! Si vishem sonte për nder të krushqvet ?

Mosnjeri hap gojë.

E mbesa, pa thënë gjë, vete poshtë, merr ca drithë, hipet lart e ia jep së jëmës.

- Mo - i thotë me pak fjalë - xa drithët, u vete ngulem se ndienj tëtim e më dridhen këmbët.

Familja e saj me krushqit priti vitin e ri tue ngrënë e pirë, me gaze e lurima. Ajo e ngrata pat të rrijë mënjanë: qepi sumbat te xhipuni e arnoi niet të shqerra.


Vitin e ri e shkoi tue derdhur lotë si dhria e thyer në mars.

Përemri vетор

Ushtrim

	atij	asaj	atyre	atë	ata	ato
Xhipunin e ha kopica				x		
Drithët ia jep së jëmës						
... i kujton së bijës						
Vitin e ri e shkoi tue derdhur lot						

Përemra të bashkuar



- | | |
|--------------------------------------|--------------------------------------|
| A <input type="checkbox"/> m'e - m'i | <input type="checkbox"/> na e - na i |
| B <input type="checkbox"/> t'e - t'i | <input type="checkbox"/> ju e - ju i |
| C <input type="checkbox"/> ia | <input type="checkbox"/> ia (ua) |

37

Kola, Sepa e kungulli

Dy miq, Kola e Sepa, vanë te Brinja pë shtenza e pë dhrom panë një pelë me një mëz prapa.

— Sa ë i bukur! Si mënd e kem një paraç? — shpërtheu së thëni Kola kur pa të voglin e pelës.

— Babalaq, tha Sepa, fshehjëm një kungull i madh te rëra si bëjën breshkat e me vapën e gushtit e sheh se na del jashtë një mëz si kali i Shën Gjergjit.

— Ku e gjejëm rërën? — pyjeti Kola .

— Te Çaferrja ku një herë lëjën kafshat të spovisme.

— E kungullin?

— Përjashta.

— Ku?

— Tata i mbolli te Fusha e Zonjavet.

Vanë atje e gjetën një luzmë kungujsh. Kola mori dy e i vuri nën sjetull: një nga anë.

Miku i tha: — Vrej se dy kunguj nën sjetull ngë mënd mbahen!

Dhromit Kola u lodh e shkoi kungullin e madh te ana e të voglit, shtu i shkapurdhiqën të dy e tue shkarë kala kala i pren drejtëzën një ljepuri.

Sepa i tha mikut: — Kolë, e pe se jiku mëzi? Nani kush e zë më! Duhen njëmbëdhjetë viet të gjejëm pameta dy kunguj pjellorë se te Fusha e Zonjavet qëndruan po shterpët si vet kulludhje.

Kola u tuj mbi një gur e klajti gjer në mbrëmje.

Në çdo fjali shëno emërorin e kallëzuesin:


1. *Kola vuri* dy kunguj nën sjetull.
2. Te Brinja *Kola pa* një pelë me një mëzë prapa.
3. Nani *kush* i zë më kungujt?
4. *Tata mbolli* kungujt te Fusha e Zonjavet.
5. Dhromit *Kola u lodh*.
6. Na *duhet* po një kungull.

Treni i fjalëvet

38

Fjala e parë është lokomotiva, numeri vagonët:

B – Berat	6 – gjashtë vagonë	bukë, bir, bathë, bisht, burrë, bosht
T – Tiranë	10 – dhjetë	telefon, tul, tjegull, trispë, tru, truall, trav, tryesë, tufë, trastë
E – Elbasan	9 – nëntë	erë, elb, emtë, etni, etje, errësim, emër, elefant, egjér, enë
K – Krujë	3 – tre	kal, kudh, kezë
F – Fier	4 – katër	fletë, fik, fjalë, fund
V – Vlorë	7 – shtatë	verë, vajzë, ve, vit, varr, vesh, vaj
S – Sarandë	5 – pesë	sisë, sy, sumbë, simjet, simbull



Ushtrim

Udhëtarë në nisje

Sh – Shkodër	11 –
D – Durrës	13 –
Gj – Gjirokastër	8 –
P – Prishtinë	20 –
K – Korçë	15 –
P – Pogradec	9 –
H – Hora	2 – dy	hon, hu

39

Një këngë për të voglin tim

Flëj, biri im i vogël;
te gjiri im flëj, thnegël.

Të do tata e mëma;
flëj, zogë, e mirëmbrëma.

Të do, zogë, edhe tata;
flëj sa e glatë ë nata.

Flëj, bir, e mos u zgjo
se mirë jot'ëmë të do.

Bo e bo, pi ca sisë
te gjiri i Shën Mërisë.

Nëse nene më ngë do,
bir, në djebë bëj bobo.

Tue tundur të voglin, merr gjumë edhe e jëma e bie ngost te ana e djebës.

Të térhequra nga drita fluturat e natës zënë valljen e tyre rrëth hërnarit. Qasen, largohen, ngjiten te muret pa lëvizur më. Flë i vogli e flë e jëma. Dhe maçja, te ana e djebës, gérhet me sytë të qepur e në dhomë ndihet po një gërr gërr i mbytur si gërgërima e ujit në lumë.

Ushtrim

Lidh çdo emër me çilësinë e vet

- bir i vogël
- gjir i plotë
- natë e mirë
- ditë të glata
-
-

Të bijtë e Darës

40

Veç Halimanëvet, një te familjet arbëreshe më të qosme të rrerhit tën ish ajo e Darenjvet të zot dherash të ndryshëm.

Një ditë, nga Pallac Adriano, Andrea Dara dërgoi të bijtë, Balën e Zanën, në Roselë për një festë me ca bujarë e ja truajti nikoqires së tyre tue thënë:

– Mos i lësh vetëm se janë maç'e mi.

Te Fikuca, motër e vëlla qëndruan karrocën e vanë te pylli për lule spartash se dhromit i gjegjën erën. Mënuan për orë.

– I thithi bota, tha karrocjeri.

– I mori era, shtoi gruaja.

I gjetën te një gropë me lise e driza: Zanën me gërvishtje te faqet, Balën me gjak te hunda.

– Ç'patët?, i pyejtën pleqtë.

E vajza: – U pash një hlun e im vëlla po thotë se ish një derr i egër.

E djali: – O, një derr i egër!

Sosën të foluri e u qepën gushë e qafë si fiq stafide kush me shqelbe kush me grushte.

Në Roselë, ashtu të nxirë e të shqerrë, shëbërtorët i morën për rrugaçë e i pritën ftohtë.

Sinonime

* i/e qos/ëm-me → i/e pasur ...

* dhe-u → tok/ë-a, bot/ë-a, truall-i...

Ushtrim

Gjej sinonimet e fjälëvet të dhëna:

- dhrom/i → rrug/ë-a, udh/ë-a, shteg/u...
- karrocjer-i → prijës-i...
- qaf/ë-a → zverk-u...
- i/e ftohtë →

41

Asht e likurë

Dhromi për Fikucën prapa malit përshkon Sëntartën. Një herë u ndodha atje në dimër kur tëtimt hyn vërtet te briu i kaut. Kush njeh vendin e di mirë. Vajta t'i jipja të ngrënët pulavet në furrik: ca gurdhu e ca krunde. Te ana e derës, papritur, pash shuk një qen me një gëzof të leshtë e me dy sy të butë çë më lipjën ndihmë. Si i fola, u ngre e më luajti te këmbët tue tundur bishtin si përfestë. E kreha me dorë. Kush e la vetëm? Mbase ca të huaj në kalim.

Ngë kisha gjë t'i jipja, pranë më erdhi një mendim: i diganisa tri ve e ja dhash. Për dy tri javë pati eshtra me mish e bukë të njomur te lëngu. Floku, shtu e thrita si e pash e para herë, u bë mik im i ngushtë. Një natë dhelpret hyrën te furriqi, e shakamisën gjithë e bëren canarin pa lënë asnje pulë gjallë. Shtu u lamë me Flokun po kujtimi i tij më qendroi i gjallë: një qen i vogël, i shkretë, i butë, asht e likurë.



Shënim

emra → m.: dhrom-i, mal-i, dim/ër-ri
→ f.: pul/ë-a, krund/e-ja, der/ë-a

E M R A	
<i>mashkullor</i>	<i>femëror</i>
qen-i	ndihm/ë-a
gëzof-i	

Dy papagalë te videotelefoni

42

Dyk: – Jam Dyk.

Dany: – U jam Dany, tē gjegjem, flit.

Dyk: – Më duke si e ngjurrët, ç'ke?

Dany: – Mirë jam, ç'do?

Dyk: – Qasu se t'e thom te veshi: dje, te Superenaloti, munda një thes gurdhu e tē pres te shpia ime tē bëjëm festë. O do tē vemi te foleja jonë në Malot?

Dany: – Mirë! Shihemi te Maloti si ngryset.

Dyk: – Mos mëno, tē jesh e përpiktë!



Pyetje:

- Kush i ha gurdhut*?
- Kush i ha groshët**? Njerëzit
- Kur hahen grurët*** te Hora?
- Si mënd thriten po me një fjalë batha, thjerri e qiqëra?

43

Jashtë të huajat!

Në çdo tufë mbiemrash një copë është e huaj, nxire jashtë e shkruaj një fjali me nganjë:

1. MAL i lartë, *i pagëzuar*, i ulët, i ershëm
2. LULE e kuqe, e bukur, fushore, *e huaj*
3. UTHULL *e shtrëmbër*, e mirë, e thartë, e fortë
4. SHPI e vogël, *e butë*, e vjetër, e madhe
5. QEN *i mënueshëm*, rrugaç, gjitar, i tërbuar
6. FLETË *e shtuftë*, e gjerë, vezake, e verdhë
7. FURRË i ngrohtë, i shuar, i madh, *i bluar*
8. DERË e gjerë, e ngushtë, *e ngathët*, e hapur
9. DELE e përdalë, shterpë, e pjellë, *e shkathët*
10. PULË piklore, e majme, e rjepur, *e rëndë*

Ushtrim

1. Djali im është *i pagëzuar*
2. Zef Skiroi plaku shkruajti librin “Te dheu *i huaj*”
3. Degët e lisavet janë *të shtrëmbra*
4. Ime motër është *e butë*
5.
6.
7.
8.
9.
10.

Antonime në akrostik

44

larg	→	A	F	ËR
gjel	→	P	U	LË
pranverë	→	VJE	S	HTË
(i) zi	→	BARD	H	Ë
(i) parë	→	SPRAS	Ë	M

Fjala vertikale është antonim i “malit”.

* Hora ndodhet ndër *fush'* e *male*.

Ushtrim

- Shkruaj ca fjali me antonime:
 - Një *vajzë* flet me një *djalë*
 - *Gjeli* rri me *pulat*
 - *Kali* i hëngëllis *pelës*
 - Në Kosovë e Shqipëri rrjedh një lumë *i bardhë* e *i zi* (Drini)
 - E hënëja është *para* ditë e javës, *e sprasmja* është diellja
 - Sot kemi një ditë *e ngrohtë*, dje patëm një ditë *ftohtë*
-
-
-
-
-

45

Vajza e sëmurë

Një mollëkuqe, më e njohur si nuse sane, ra nga një ordangaf e theu krahët e sipër-më, ata të kuqtë me pika të zeza. Çajti edhe kryet e qëndroi pa zë.

Një dhëmbje e madhe për të jëmën !

Për shërimin e sat bije - i thanë Zonjat e Gropës së Mollës - i duhet një bar o ca ujë malit me cilësi të rralla. Barin ia dha nuna Flutur, po sëmundja e vajzës u keqësua.

E ngrata mëmë iu lut gjithëve për të bijën. Sa lot i ranë, mosnjeri e di, natën e ditën, jashtë syvet të saj. E mjera ngë pati më prëhje.

Vajza piu e shtrydhi aq lëngje sa u vel: ashprele, çinxallore, splitër...

Ndër kandrrat flitej për një morr liti me aftësi mahnitëse.

- Ku rri ky zoti Afide ? - pyjeti gruaja në gjitoni.

Ia thanë e vate e gjeti. Morri e ndihi.

Në do mirë tët bijë - i tha gruas - kërko burimin ndër Gurët të rarë të Xunxelës. Si e gjen, jipi sat bije një lugë ujë kur gdihet e një kur ngryset e parkales të lartin Zot me besë të patundshme se...

E mori vesh e, me uratën e tij, vate përjashta. Nga duba e një rrapi pa burimin e Badheut e vat' e mori ujët.

Për një javë të tërë ia dha vajzës dy herë në ditë, po ajo s'mirësoi gjë.

Mëmë mollëkuqja u pruar te rrapi e nga duba më e lartë pa një burim tjetër, atë të Marxhit. U lëshua te hijima e, sa ka çë te thom, gjeti kroin me ujë të pijshëm.

Vajzës i dha një lugë nga ditë, po java shkoi pa të reja. Të hënën mëmë mollëkuqja hyri si çdo menatë te dhoma e shtratit të vajzës, hapi dritaren e me zë të butë i uroi ditën e mirë. Ajo shqepi sytë, mori frymë e hijshëm iu fal:

- Ditën e mirë, zonja mëmë !

E jëma e shtrëngoi fort në prehër, e puthi më se një herë e në sy i shkanë lotë gjëzimi.

Mbiemri pronor

Ushtrim

Nxit nga teksti mbiemrat pronorë të vënë para emrit:

mbiemr	emr
e sat	bije
tët	bijë
...	...

Një rrahadere

46

Vo Nina leu te Hora në vitet e së dytës luftë botërore, sheh e gjegjet pak, po ë e zgjuar si vajzë. Njeh mirë të rejat e të dhëndrrat, të niprat e të mbesat një për një.

- E xure se somenatë të kërkojn? - i thotë gjitones.
- Kush ?
- Ngë e di.
- Sa vetë ishën ?
- Po një. Ish një mike jote ?
- Çila mike ? Ç'vjeç ftoj ?
- Njëzet.
- Të tha gjë ?
- Mosgjë. Priti ca herë prapa derës e vate.
- Sa ?
- Dy minute e vate pa folur.
- Me ç'lloje pethkash ish veshur ?
- Ndutu mirë jo.
- Mirë, me sa gjegjem, ajo ish një rrahadere.

Përemri pyetës

Ushtrim

Nxiri nga teksti:

1	<i>kush</i>
2	
3	
4	

47

Zonja Fanë

Zonja Fanë ë ë një grua familjeje bujare. Ë e vetme e thotë se martesat, si shartimet, bëhen me drunj të ngjashëm. Kreh flokët në zverk e bën tupin. Ë një pipiruqe !

Dje bleu një pulë, i nxori zorrët, e lajti dhe e ngrëhti. Te hera e të ngrëniti një mike i ra te dera. Zonja Fanë fshehu pulën e shuajti zjarrin.

- Harrova kliçet brënda - i tha. Më lë tē rri me tij? Pres tim shoq.

Hyri brënda, po ngë mënoi e tha:

- Gjegjem lëvizje te kuçina ... ke gjë ?
- Mosgjë - iu përgjegj zonja Fanë me faqe të kuqe.
- Më duket se me tē ftohtët dridhet ... rope pula ?

Zonja Fanë, pa pritur më, mori pulën, e shturi te kudhi e i shtroi tryesën mikes tue thënë se, kur një ha vetëm, tē ngrëniti ngë bën mirë.



Përemri vетор

Ushtrim

Përemra vеторë		u / ne	ti / ju	ai / ata
Parafjalë				
me	mua	tij		
	ne			
veç	meje	teje		

I huaj në dhe të huaj

48

U hap gjuejtja e zogat lanë foletë e vjetra të mos ishën zënë.

Vanë larg po, mirse të shpërndara, vendet ku lenë s'i harruan kurrë.

Ca spovisën dhromit e mosnjeri di sa.

Çdo vit në maj, kur bar e lule e bëjën më të pashme përjashtën, mblidhen te një faltore anë malit e me përgjërim e tone vajtuese këndojën *O e bukura More*. Gojë më gojë kujtimi i ikjes u rua gjer te stërniprat.

“Dua të vete në Atdhe” - tha njeri prej tyre e përtej detit gjeti vendin e të parëvet.

Pa malet, lumet, fushat si ia kishin përshkruar: në rrethin e ... Tomorin, në rrethin e ... Shkumbinin, etj...

Pa Arbërinë, Himarën, Çamërinë, po gjërat më të vogla, më të imëta s'i pa fare.

Fshatrat arbëreshe i thithi dheu: asnje gërmadhë, asnje gorromimë. Heshtje e plotë!

Ai u mundua të gjejë edhe një copë tjegull për kujtim, një qaramidhe, po shkretëtira dogji gurë e mure pa mëshirë.

Mosgjë, mosgjë lanë pas tyre Buat, Muzaqrat, Barkat, Topitë ! Një vegle të thyer, një hërnar, një kupëz prej bakri. Mosgjë. Heshtje e plotë !

Nga deti Jon lundroi gjer në Egje tue kërkuar farefisin e Niotëvet, të Kandjotëvet, Rodhjotëvet e Skironjvet: mosgjë.

Kur u kthyesh në Horë, iu duk se as arbëreshët ishën më ata të katundit e për të parën herë u ndie i huaj në dhe të huaj.

“Kujtimet - tha - më ngjallën po fantasmë” !

Përemri i pacaktuar

Ushtrim :

- Në shpi ngë gjeta _____
- C’të tha yt vëlla ? _____
- Mos i bëj të keq _____

mosgjë
mosnjéri
askujt

49

Një ndeshje baluni

Skuadra jonë “Groshët” hyn tue kërcyer në gjysmën e fushës e çdo lojtar zë vendin e tij. Në anën tjetër kundërshtarët “I legumi”. Pritet vetëm frushkullima e gjyqtarit të garës, lusitanit Zot Fasulas.

Lojtarët tanë janë të ndezur, tifosët gojëmadhra të njohur.

Nga të gjitha kthesat e fushës ndihet “poshtë, poshtë”, po edhe të huajt lurijën “viva i legumi”. Suvala ngjipet në të dyja anët. Shihen në fushë Batha, Thjerri, Dhëmballa... Mosgjë dihet për Qiqren të çilit dje i erdhi një ngërç në të sprasmet minute të stërvitjes pas një shkelbi te kërcinjtë.

Në pankinë rrinë duarngryq Elbi, Tërshëra, Treu... Nesër turni i “Grurëvet” me “I cereali”. Qëndruan jashtë Gurdhut e Sullimat. Te ky minut ndeshja po merr ... këmbë. Një pikë për ne ! Dy pika ! Tifosët tanë më këmbë njurren tue thënë “mujëm, mujëm”! Sos ndeshja e lurimat ndihen mbatanë Kumetës.



Groshët sot nesër grurët,
na po ju çajëm glurët.
Rroftë, rroftë e përjetë,
një për njëmbëdhjetë.

Përemra e mbiemra pronorë

Shënim:

skuadrat / i - e skuadravet / skuadravet / skuadrat / skuadravet

t o n a

Ushtrim :

lojtarët / i - e lojtarëvet / lojtarëvet / lojtarët / lojtarëvet

→ _____

Zgjidh e shëno :

përemër

mbiemër

tanët →

tanë →

Një udhëtim i ëndërrt

50

Një gjel rep ndërroi vend sa të gjej pula e të ngrëna më të mira.

Dhromit pa një maçë e i tha:

- Eja me mua. E vate me atë pa mënuar.

Te një lumë shoqëria u zgjerua më se sa pritej me tre brethq, dy gërvhje e një breshkë.



- Ejani me ne. E me pak fjalë vanë me ata.

Si u ngrys gjeli gjeti një degë panje e u vu të flëj.

- Ç'hamë sonte ? - i pyejtën të gjithë.

- Mosgjë - tha gjeli me sy të qepur prej gjumit. - Për mua ë hera e prëhjes.

- Ndienj tëtim - tha maçja - me të ftohtët e mbrëmjes.

- Na dredhen zorrët - thanë të tjerët e njeri pas tjetrit u prorën te lumi ku ishën ditën.

- Udh'e mbarë i uruan gjelit tue u larguar.

Maçja gjeti të zonjën në pritje te dhoqena e hyri brënda me bisht nën bythët.

Atje vetëm si ur te zjarri, gjeli tha:

- Dua prirem te ngastra ime edhe u. E vate brënda.

Në gjum i dukej se ish te një lëmë ku pa peng gjej gurdhu, krunde të ngjeshur, kokrra, kakazorrë të majme të majme, krimba, me një fjalë gjithë buritë e botës.

Një gjumë i glatë e i hijshëm !

Në të gdhirë mosnjera te pulat e gjegji t'i falej mëngjesit e për hidhërim pollën po ve kulludhje. Dëstuan.

Veç kësaj, kur në mbrëmje e panë te lëmi, u trëmbën aq sa për një javë të tërë ndenjën pa kakarisur.

Përemri vëtor

Ushtrime:

rri me _____

pranë meje

teje
ne
mua
ju

rri me _____

pranë nesh

rrimë me ty

pranë _____

rrimë me _____

pranë jush

5I

Nuse - dhëndërr

Një krimb lëvrij tue ngrënë një fletë lakre.

- Mos u ngop - i tha një gjiton - se nesër kemi festë te shpia e Rriqërës madhe.

- Ç'festë ?

- Festa e pranverës. Mos harro të vish ! E dinë morrat, pleshtat, kërmijtë, këpushët, kakazorrat ...

Krimbi vate te këpucari e i tha:

- Dua mbathur pér festën e pranverës.
- Sa këmbë ke ? Miza gjashtë, rriqëra tetë, gérthja dhjetë, ti sa ?
- Ngë e di, vrej ti.
- Një, dy, tri, katër, pesë, gjashtë, shtatë, tetë, nëntë, dhjetë... mëmëza ime, sa këmbë ! E kush i ka te Hora kaq këpucë ?!

I mjeri vate brënda tue shëmbur. E gjegji plakarusha e Xunxelës e pati mëshirë pér atë. Mori ca lesh delje të vjerrë te drizat e natën, pa marrë gjum, e tjerrti me boshtin e i bëri njëqind këpucë me bojrat e mollëvet.

Krimbi vate te festa e atje njobi krimbëthin e zëmbrës. U bërën nuse e dhëndërr me unaza bari, po pér muaj ndenjën në lluvi më vete. Pritën t'i rriteshtën krahët e kur erdhi prapë moti mirë, fluturuan bashkë e mosnjeri pa ku.




Përemra e mbiemra të pacaktuar

Shënim:

- Sa këmbë ke ? E kush i ka te Hora kaq këpucë ?

Ushtrim:

_____ këmbë !
_____ këpucë !



Nusja e karkalecit

52

Një karkalec këndoja mbi një shegë tue fërkuar krahët, i tërhequr nga një mollëkuqe, atje pranë e zalisur prej vapës.

Me këmbët e përparme piklorja i ngau brirthët e i tha:

- Ngë jemi lerë për njeri-tjetrin, gjej në rrëthim tënd nusen për tij e harrojëm.

Shtriga, me sytë të dalë, i gjegji e për zili i hëngri të dy dy me mashën e saj plot helm.

Dhe cinxra ngë hapi më gojë për ca muaj.



Përemra e mbiemra të pacaktuar

Shënim:


Ngë jemi lerë për njeri-tjetrin.

Ushtrim:

Njera dorë lan _____

Njera vajzë i foli _____

Shoh dy njeri: njeri ha, _____ pi



53

Semafori



Një breshkë arrën te një kryqëzim e semafori e lë të shkonjë me të kuqin pa thënë gjë. Vetëm një pyejte:

- Kjo mbulesë ë targa jote ?
- O, ë targa ime e më mbron nga inçidentet.
- Arrin një kërmill e shkon dhe ai.
- Po një minut: ëm targën tënde.
- Guaskë.

Më tutje arrën një aligator, e qëndron e i bën të njëjtën pyejte:

- Çila ë targa jote ?
- Carapace për ne italianët.
- Mirë, paqja na duhet edhe neve e është vërtet e shtrejtë.

I falet dhe e lë të ve.

Prier sytë e sheh një kakamill pa targë e plot jargë.

E qëndron e...

- Ku e le targën tënde, e le brënda, ë ?! Pa shih, nani mbështille me qurr mos të shoh ? Kontravencion !

- Si, - thot butaku - të tjerët i ke lënë të shkojnë me të kuqin e me të verdhin e mua më bën të paguanj me të blertin ?

Te verbali i shkruajti një numër po me zero e kakamilli pat të vëj syzet për t'ë vërtetuar.

Ushtrim: Çdo mbiemër në kontenitorin e vet

dëftor	pronor
kjo,	jote,

Steri i vetëm

54

Te një shesh stisën një ster të glatë të glatë e retë i qepën një ksulë mbi krye për kapak.

Kush shkoj atje, domosdo një peng ia vëj:

- Ky ster stenet ndutu !

Në të vërtet ai rroj lig: pësoi dhunën e furturës e të ftohtët e dimrit, vetëm në qiell, me krye të pësht-jellë, me linë e dritarevet në kurm. Më se një herë i ranë lot e fëmijëvet u dukej se bij shi.


Një ditë pa ca burra me lopatë, kazmë e vegla pune të tjera e tha:

- Më rrëzojën ! Më mirë kështu për mua se pa njeri te ana.

Një menatë nga lart pa një copë mur çë po rritej si brumët të ngridhur. Pak e pak e sosën të stisuri e mjegullat, pa mënuar, e thurën rreth e rrotull.

Sterit plak i qeshi buza se ngë ish më vetëm.

Natën njeri i rrëfyej një pullare tjetrit e mosnjeri përdhe i gjegjej.



Mbiemri i pacaktuar

Shënim:

një tjetër mot

kujtimi i *një tjetri* mot

po prirem *një tjetri* mot

kujtonj *një tjetër* mot

Ushtrim:

mote *të tjerë*

kujtimi i motevet _____

po prirem motevet _____

kujtonj mote _____

55

Ai ë tata

Ritratin e tij tata na e dërgoi me postë pas nisjes për surdat e përngjitjen me copën ku duke-mi të tre (u, ai e mëma) e bëri fotografi në laborator.

Asnjë letër morëm pas shpërthimit të së dytës luftë botërore.

Një ditë erdhi te Hora një maghare e gjithë grat me bij e burra në luftë vanë tek ajo për lajme. Thuhej se njihëj embër e mbiembër të të gjallëvet e të të vdekurvet.

Mëmës, pas ç'e paguajti, si të ish në fatthënësin e Delfit, i tha:

-Ti grua, yt shoq mund të rronjë e të mos... se peri i tij ë ndutu i dredhur.

Ajo natën u jos në lot. E ndjemja ish grua e ndjeshme.

Një ditë, papritur, ku ndodhet përmendorja e ushtarit të panjohur, pashë një surdat vërtet të panjohur.

Më thritën në shpi, gojëhapur, e në atë njoha tatën rob në Gjermani prej vitesh.



Mbiemri i pacaktuar

Shënim:

Asnjë letër

Ushtrim:

_____ gratë vanë tek ajo për lajme.

_____ gra vanë tek ajo për lajme.

_____ grua vate tek ajo për lajme.



Lëmi (*ditar*)

56

Në të korrat hjaravolet i lëmë kudo përdhe. Pritet lagështia e mbrëmjes sa të lidhen dhomate-dhomate. Nga hjaravol ka dy gjymsa. Te dhomatit hjaravolet (tetë, dhjetë) vëhen një me krye lart e një me krye poshtë. Ndoherë lighama, tue shtrënguar, këputet e duhet durim të lidhen pometa copat përbërëse. Çdo stavë ka gjashtë dhomate se kjo ë barra normale e mushqvet.

Pas të korravet kallinjtë shihen, vjen me rarë shkoqen, te lëmi nën thundravet shtypëse të mushqvet e, kur fryn era në rahjin, hijidhen me digirjan e lopatë druri: kashtha, bykrat e halet mblidhen te një anë, kurse drithët qëndron te lëmi. Të nxiren gurdhut, grurët shoshen me dhrimonin e, kur janë të pastruar, vëhen te theset.

Kashta ruhet për dimrin e sillet në grash me rrutune.

Ndajfolja

Shënim:

kudo ① kur

ndoherë ② ku ①

Ushtrim:

Gjej lidhjet ndër ndajfoljet

A	dikur herët dje sot nesër kurre	B	arbërisht shqip shtu mirë keq lig	C	këtu atje poshtë lart brënda	D	pak kaq aq më tepër	E	o ëj jo mbase mund omse
---	--	---	--	---	--	---	---------------------------------	---	--

ku C kur sa si pohim-mohim-dyshim

57

Të korrat

Kur drita ende mënoj mbi Gurin e Lartanit, te qëroi i të korravet, pa għidher, mëma vēj tē ngrēnat e verën te duaku pér tri ditē rresht; tata i vēj burroren mushkut tē straisur, kapistrēn, i shtrēngoj qenglien, nënabishtjen e nglako lighamēt.

Në fund mëma, me pak fjalë, më zgħoj mua:

- Te Sëntarta... arat... tē korrat...

Më para shkojēm te kroi (ku njéherē isħen rrapet) e potisjēm mushkun. “Te gurēt e daljes” prindi te burrorja e u vithe. Te pujata e Xuhait tata qendrisej mushkun me thubbin tē mos qendrojēm prapa: një luzmē mushqish njeri pas tjetrit e një muzikē thundresh pa variacionē !

Drita na għej nē punē me drapret nē duar. Gjithē ditēn me buzē te dħeu e më njē vapē čé na thaj trutē e nxij likurēn si nē shkretetir. Flējēm te kallamet edhe pa pēshtrim. Nē mëngjes laħeshim me njē ngħalluq uji te lugħet e duarvet e vetem pér pastrimin e syvet.

Sħtu u rriten fshatarét e argatet e Horës għer nē vitet pesēdhjet !



Pēremri i pacaktuar

Shēnim:

Lidħje ndér pēremra

mosnjeri	asgjē
asnjeri	mosgjē
ndonjeri	ndogjē

Ushtrim:

Sot _____ më kuar me drapēr te Hora.

Sot _____ më dinē djemtē rreth tē korravet me drapēr.

Ende sot _____ kuar me drapēr.

Maçja ime

58

Maçja ime ka qimen e . Ës një gjumëmadhe po natën ngë flë kurrë sa të zënë ndo mi .

Kur më sheh gérhet se do dugulisur te kryet si mollë. Më duket një panterë e ha me èndje pishq, patate e mish .

Mbiemri cilësor

Ushtrim

Çdo mbiemër në vendin e tij.

<input type="text"/> e zezë.	<input type="text"/> të vogël
<input type="text"/> e butë	<input type="text"/> të zier
<input type="text"/> të diganisur	

Kujdes !

Ca prapashtesa zvogëluese të emrit e të mbiemrit

Shtu:

- hënxa (hënëza)
- bukëza
- yzet (yllëzet)
- topëza
- danxë (nd'anëzë)
- mënezi
- cingël
- dardishke
- plakarushe

Fjalë pa fund

Një plak zezak
me syzet
për pak
vuri të zezat
në lip.
Një nip
e xuri, e zuri
e njize ia nxori.

59

Të vjelat

Pas të vjelavet, mosnjeri më, djem e vajza, qëndroi në vreshtë: kush vatë për këpurdha, kush për llapsana. Më të vegjit vanë për ftonj. U bë dhe loja e lëndës: “si i gjen cilësitë e ftoit”?

ME → vesh ① dorë ② gluhe ③ hundë ④ sy ⑤

- 1 Ftoi - tha Zefi, - ë një frut vjeshtor. ①
- 2 Lëvorja e ftoit ka përreth një pushje të butë. ○
- 3 Tuli i ftoit ë i athët. ○
- 4 Ftoi lëshon një erë të mirë. ④
- 5 Me ftonjtë bëhen marmelata të embla. ○
- 6 Fara e ftoit ndodhet brënda një xhelatine ngjitëse. ○
- 7 Likura e ftoit ë e verdhë, tuli i bardhë, fara e murrme. ○
- 8 Ftoi ka një formë rrumbullake. ○

Emra mashkullorë të shquar

Ushtrim

Çdo emër në vendin e tij.
ftonjtë, i/e ftonjet, ftonjtë, ftonjet

njëjës

Ftoi ë i athët.*Lëvorja e ftoit* ë e hollë.*Ftoit* i ranë fletë.*Ftoin* e lashë mbi tryezë.Mes *ftoit* gjeta një zogë.

shumës

 janë fryte të egraTuli ë i athët.Në dimër u bien flëtë.Me bëhet marmelata.Mes gjeta një zogë.

E bukura e Durdjepit

60

Një herë karburanti i fantasisë buroj e fluturohej pa ndotur ambientin.

Vegla më në dorë për çdo udhëtim ish shkopi i fshiesës.

Kristinën, një kopile sëndastinare, aq e bukur, mosnjeri e lypëj për nuse.

Një ditë dimbri, tue parë zborën nga dritarja, mbylli sytë e sa u gjënd te një vend pa i njojur më para: një asteroide ku vendësit ishën hije. Atyre ajo iu duk një zanë e i thanë:

- Në do të përjetohesh, shko përpara kësaj pasqyre.

I mori vesh, vetëm se me qëroin bukuria e saj u prish. Si u mblak, la vendin e u pruar ku leu, majde Durdjep ndër lise e plepe mos ish parë në atë pamje.

- Jam e bucura! - tha.

Për nikoqirë mbaj një kopil e një kopile të transformuar, me magjinë e asteroidëvet, në lajtorë e fshiesë mekanike. I magjepsi me një tufë lulesh sparte.

Një ditë dimbri e papritura!

Hyri brënda një mi e grijti librin e magjivet. Plaka vdiq e ata rimorën format e tyre njerëzore. Ish natë, një natë dimbri me zborë. Të dy, dora-dora, pa folur, si flutura, gjetën dhromin e shpisë. Petalet e spartavet ranë mbi zborën e në pranverë, ku shkuant, lulëzoi një gardh.



Emri

shi-u shok-u mik-u dhe-u fik-u

Shënim

njëjës

Ushtrim

shumës

Çdo funksion në rasën e vet

E GJ DH K RR

Një mi grijti librin e magjivet

Ca mive gratë u trëmben

Cijajtja e një miu ndihet mirë natën.

Misht e ca mive maçet ng'e hanë.

Një miu i prenë bishtin.

Ca mi u fshehën te kashta.

Pashë një mi te linoi.

Maçja zuri ca mi. K

Prapa një miu maçja u lodh.

Mes ca mive pashë një rric.

61

Pastërtia e ambientit

Mes gurëvet, anë liqenit tonë, veç plëht, die ambientalistët gjetën një lizmë lati-nesh e shishesh të mbrazta, balune të shfryrë, copa të hallasme e të shqerra, drunj, dërrasa, hekure, etj...

Me pak fjalë një pusullë njobjeje njerëzish pa respekt për natyrën. Një dëm i madh! Këto materiale, dihet, shiu i lan, po ngë i jos.

Duhet dora e njeriut të nxiren ku i lë gjindja, nëmos qëndrojën atje për jetë.

Ambienti ë një pasuri e të gjithëve e duhet ruajtur nga të gjithë.

Emri

Shënim

Ushtrim

Plotëso fjalitë: *shirat, i/e shiravet, shiravet*

njëjës

shumës

Shiu lan rrugët.

_____ e dimbrit janë të përditshëm.

Frym era *e shiut*.

Stina _____ ë dimbri.

Mos iu trëmb *shiut* të rreptë.

Brethku s'u trëmbet _____.

Bota pret *shiun*.

Me _____ zë mot' i keq.

Pas *shiut* del dielli.

Pas _____ mbollëm farat.

MOS LËNI
PLËH
MBI VEND

1	jinar
2	flevar
3	mars
4	prill

KALENDARI

i qëroit për *kërmijë*

Për këtë lojë i duhet vetëm një sumbë nga lojtar

12	dhjetor
11	nëntor
10	tetor

5	maj
6	qershori

7	korrik
8	gusht

9	shtator
---	---------

①	Je një kërmill	Bie shi, dil jashtë e ha bar	②
③	PENG Frym erë, hyr brënda e rri një ditë pa tundur.	Mot i mirë !	④
⑤	U cite me bar, nani prëhu për pesë muaj e argjëro.	Vapë ! Priru te prilli se gjen mot të mirë	⑥
⑦		PENG Flëj e mos tundesh!	⑧
⑨	Retë enden në qiell, të vjelat sosën.	Natën ra shi me shoshin. Te një luce ë në pritje një brethk. Shko te prilli.	⑩
⑪	Bie zborë, priru përpara te flevari.	Je në prag të vitit të ri, gëzuar !	⑫
		M U N D E	

Emri

krund/e-ja vajz/ë-a lul/e-ja

<i>njëjës i shquar</i>	ditë/-a	e shtunë/-a	nxir/e-ja	njohj/e-ja	mëri-a
------------------------	---------	-------------	-----------	------------	--------

URIME

TË NGROHTA

Shumës i shquar

	E	Gj	Dh	K	Rr
ditë	t	vet	vet	t	vet
mëri	të	vet	vet	të	vet

63

F J A L Ë P A F U N D

Muajt e vitit

Vete për hua jinari
tek i vëllai flevari.
Ç'më lyp ?- lurin i ngrati
-ka pesë muaj çë jam te shtrati !
Uria më shkul sytë
e ti do hua një ditë ?!

Marsin e merr era,
prillit i bie te dera.
- Ç'do gojëmadh e i lënë ?
Ti vjet më le pa ngrënë,
se, tue fryrë në arë,
atje u rrit po bar !

Maji i butë gjithë lule,
ha e mahet me tule.
Qershori e pret në mal.
Bredh poshtë një suvalë
e arat kreh të thata
me ditët më të glata.

Korriku me një napë
qafje hyn e bie vapë,
djersë, lodhje e etje.
Djeg gushti e rri në pritje
të ngrohet hapësira
e të piqet pa shira.

Shtator, tetor, nëntor
një vëlla i mban për dorë,
i vesh, i lan, i mbath
e rrin me brumë e bathë.
Dhjetor ë embri i tij
e gjithë i do si bij.

Emri

djal/-i gur-i bar-i nip-i

Shënim

- * marsi ë një muaj i ftohtë
- * tëtimët e marsit hyn te briu i kaut



marsin

marsit

marsi

Ushtrim

- _____ prillit i huajti “katër plaka” .
- _____ e shkova anë vatrës,
- pas _____ vajta Romë.

Mullinjtë në Horë

64

I pari mulli në Horë u stis te Quza, në kurriz tē malit. Thelimën nga Monreali e patëm në vitin 1508, njëzet vjet pas themelisë së fshatit ténë. Më para drithët bluhej në Malvelo e Jato.

Më tutje u shtunë themelet e tē tjerëve mullinj: gjashtë-shtatë në përgjithësi e tē gjithë, veç tē parit, bluajën me ujët e lumevet Gjon e Varfër. Dy prej tyre ndodheshën në fushë e një te Honi, mbatanë malevet. Asnjë rrënojë tē mullirit në *Scala di la fimina*, kurse ato tē Çaferrjës janë nën ujë. Një te më tē vjetrit mullinj, brënda Horës, ë ai i Sëndurrokut me një ghurgh në qafë.

Në Strit, gjer më sot, duken muret e sterni i mullirit tē stisur në shtratin e Varfërit, degë e lumi Belice.


Mullirin anë Shën Kollit e stisi Tur Belushi me lejë tē vitit 1565.

Mullinjtë aktivë në tē sprasmet qëronj ishën ai i mas Japkut Masi, përpara Sunduvitit, ai te Kughiri e ai i Fushës së Pontit.

Mos harrojëm atë tē Sëndurrokut e atë tē Shën Kollit.

Në çdo mulli dy mokra, me fërkimin e tyre, thërrmojnë drithërat e tē gjithëve.

Te theset miell e krunde ishën tē përzier e gratë i ndajën me shoshin e hollë.



Emri

ujë-t *mish-të*

Shënimë

- * më duhet *ca drithë*
- * më hyri një halë *drithi* te syu
- * *ca drithi* i zuri krimbi
- * bluajta *ca drithë* te mulliri i ri
- * buka *prej drithi* ë e ëmbël

Ushtrime

- | | | | |
|---|----------|------------------------------------|-----------|
| 1 | ca ditë | 2 | të ftohtë |
| 2 | mora | <input type="checkbox"/> e ftohtë | |
| 3 | një ditë | <input type="checkbox"/> të ftohta | |

65

Vapë

ulliri
 shtrydh shkëmbin
 pér ca ujë,
 glëmbat e lopatavet
 shpojën
 pasqyrën e lugët tē qiellit,
 etja më djeg
 po retë lanë hapësirën time

Emri

Shënim

forma e shquar

ujët tē Xunxelës ë tē pijshëm
 pika *e ujit* shpon gurin
ujit amull i bëhet lipi
 piva *ujët* e kroit
 rrreth *ujit* u rrit bari

Ushtrim

forma e pashquar

gjej format përgjegjëse

piva ca _____ tē ftohtë
 kam etje _____ 2
 ca _____ tē ftohtë më shuajti etjen

- | | | |
|-----|---------|---|
| E. | ujë | 1 |
| Gj. | i/e uji | 2 |
| Dh. | uji | 3 |
| K. | ujë | 4 |
| Rr. | uji | 5 |

Kujtimet e Sarës

66

Sara i kujton me ëndje të madhe të sprasmet ferje te brinjat e Surfarelit, gjumet përposh hjesë së butë të ullinjvet, të ecurit me mikën Leksa në pyjet anë liqenit.

Pas vapës, të parët shira e kthimi në Horë !

Përjashta nani garifin si pushje rrëth vilës e shkel po ndonjë maçë e altalenën te dega më e trashë e lisit, anë shkëmbit, me duar të fshehta e tund vetëm era. Dritaret mblejën sy të hapur në ajrin e hirtë e tymuesi i vatrës një hu shterp në tulin e hapësirës.



Surfarel në dimbër fryn erë e ftohtë. Sara pret natën e Krishtlindjes të priret atje me familjen e saj. Një luzmë vetë në katër mure, po ë vërtet se çdo shpi nxën sa do i zoti.

Tryesa ë plot me të ngrëna: mish, likenkë, pula, zorrë kaqici, petë me sard-kuprime, qepë, rigan, sarsë e udhos, verë të kuqe, pemë, panetone, të embla me gjizë. Zjarri tymon. Jashtë bien floqe.

Sara po pret dhuratat nën bredhin e bardhë. I ngjet një pupë e me atë në gjii merr gjumë nën pethkat e vakëta të shtratit.

Nyja

Shënim



* erë e ftohtë

* me duar të fshehta


* Sara flë përposh hjesë së butë të ullinjvet

Ushtrim

Çdo nyjë në vendin e saj

- * preva një degë ulliri
- * preve dy degë lisi
- * preu tri degë ilku
- * premë katër degë vidhi
- * pretë pesë degë plepi
- * prenë gjashtë degë rapi

- * degët _____ plepit
- * dega _____ lisit
- * degën _____ e _____ vidhit
- * degëvet _____ rapit
- * degës _____ ilkut



67

Furturë e breshër

Frym erë e ftohtë e hapësira ë trubull, e errët. Kafshët fshihen te gropat, nën gurët, te të thyerat e druvet, ku mënd.

Era po tërbohet e rrin shpejtësinë e saj tue pjerrë degët e druvet.

Rrufe të rrepta përshkojën ajrin, gjëmojën malet anembanë. Bota hap gojën e thith të parat pika uji. Sos shiu e zë breshëri. Qiqrat mbi tjegullat po trashen e bëhen më të ngurta, shurdhusese. Breshëri merr format e truallit e mosnjeri i shkel ndër gjëma e rrufe. Furtura ngrën tjegullat, shtrëmbon ujëmbledhësit, hyn te briu i kaut. Mosnjeri del jashtë e pret.


Omse dhe ulqit i trëmben shtrëngatës... e rrinë në pritje të motit të kthjellët.



Emri

Shënim

gurshkrepës-i
gluhëka-u (bar)
gurthyes-i (bar)
nënabishtj/e-a
mirëdit/ë-a




- A - *gurshkrepës* në Shqipëri domethënë gur zjarri
 B - *gluhëkau* ë një bar ngjitet
 C - strehët e shpivet përjashta janë pa *ujëmbledhës*
 D - *nënabishtjet* e shalëvet e të burrorevet bëhen me likurët

Ushtrim

Çdo emër i përngjitur në vendin e tij:

- A.1 - _____ ë i pafund
 B.1 - _____ nxiret nga përpunimi i naftës
 C.1 - Tata ka gjashtë _____ e pesë stërmbesa [K].
 D.1 - _____ rriten te arat



Mici

68



da e prini gjirin e mëngjesit. Kujdes.

Del e jëma e del edhe këlyshi më i vogël: Mici. Tue bredhur qëndron nën lisimadh anë pérroit. Lëpin ujët, lag buzët e kreh qimen: një lëmsh bore !

Nën një stavë drush të thata, pa dashur, sheh një gropë e, tue shkalisur, hap galeri në çdo anë. E jëma e gjen në pikën më të errët të gropës, e zë me gojë pér mesi dhe e nxier jashtë. Në strofkë ë hera e gjirit. Mici zë një thithë e, tue pirë sisë, merr gjumë.

Emri

Shënim

ujë <i>pérroi</i>	ujë të pérroit
tirq <i>grash</i>	tirq pér gra
krëhër <i>ashti</i>	krëhër prej ashti
nxire <i>druri</i>	nxire prej druri
ujë <i>burimi</i>	ujë nga burimi
vegle <i>therësi</i>	vegle pér të therur

Ushtrim

- ca fletë *fiku* ranë te dheu me erën Rr
- ca lloje *grurësh* mbillen herët ○
- mëma lan pethkat te pylla *druri* Rr
- te pagëzimi, veç arravet mulize, dhuruan ato *gurje* ○
- te Fusha gjeta ca këpurdha *gjizje* ○

Shprehje

një luzmë mizash	një nxire (me) ujë	një kil mish
një tufë lulesh	një thes (me) drithë	një litër vaj

Mëma ljpegur, e helqur si krëhër, në ditët e lehonisë del herët pér bar. Pa ngrënë si mënd rriten shtatë këlyshë, si mënd rriten kur po i rrinë qepur te thithët ?

- Mos veni jashtë - u thotë tē bijvet në tē dalë. -Rrini brën-

69

Mihaili

- Mihail, ki kujdes për shpinë e për gjyshin te shtrati, - i thotë e jëma në të dalë jashtë për ca shërbime. - Te hera e të ngrënët shtro tryesën e shtje brumit. Mos harro kripën kur prier valë. Veç të tjeravet, kujto se sot pres rrogën. Mirre ti postën e mos harro ku e ngrën.

Mbi ca herë bie zileja: ë postini me një zarf. Mihaili e merr, e shqierr dhe e shtie te plëhët copa-copa.

Zileja i bie të ditën herë e hyn mas Çiku.

- Ka qeth plakun, - i thotë djalit me pak fjalë. Zbyll. Më duhen dy minute të sos. Te hera e të ngrënët e jëma ë brënda.

- E ziejte brumit ? - i pyen djalit.

- E ziejta - i përgjigjet ai.

- E ku e le ?

- E shtura te plëhët, si më the zotrote në të dalë, me një grusht kripë të qethjes.

- Mjera u ! E zarfin me rrogën e moit ku m'e le ?

- E shtura paraç te plëhët me brumit !

Së mjerës i ra zali e ngë foli më.

Emri

Shënim

lul/e -ja -e -t
gërtj/e -a -e -t
nuseri - a - -të
grerëz -a -a -t

gëershër/ë -a -ë -ët
A B C D

→ kjo gëershërë ngë pret më
→ gëershëra u thye më dysh
→ na lypsen dy gëershërë
→ gëershëret e qethjes janë të mëdha

Ushtrim

Çdo fjalë në vendin e saj

Nga _____ ka erën e saj A

_____ ka dhjetë këmbë B


Ca _____ të sotme bëhen pa krushq C

_____ foletë e tyre i bëjën te glëmbat D

gérthja
grerëzat
lule
nuseri

Sinonime:

zarf - i
bust/ë - a



Kryeziu i hamuleve

70

Qimja e Kryeziut ë e dredhur si të glëmburat hamule ku flë e anë hundës i mbledhur si fshiesë e shkrifur.

Ai rron larg gjithëve, ha vetëm e natën po leh: hjevet, dhelprevet, xixëllonjavet. Mosnjeri te Manali thotë se ngë e njeh. Dje, në mbrojtje të Fufit, u sul mbi një tufë qensh e, si i panë dhëmbët jashtë, u tërhoqën me bisht ndër shalë. Mbrëmanet Kryeziu u ngul më anë vathës e jo më te hamulet.

Tufa e tërë nani i nënshtrohet pa të zëna.


Emri

Shënim

një fletë lakre
ca fletë lakrash
fleta e një lakre
fletët e lakkës

Ushtrim

një bisht _____
ca bishtra qensh
bishti i një _____
bishtrat e _____



A : (një) qen / i, e (një) qeni / (një) qeni / (një) qen / (një) qeni

B : qeni / i, e qenit / qenit / qenin / qenit

C : (ca) qen / i, e (ca) qenve / (ca) qenve / (ca) qen / (ca) qenve - qensh

D : qentë / i, e qenve / qenve / qentë / qenve

71

Një fletë e historisë sonë

Një herë lidhjet e Horës me Monrealin ishin më të ngushta se ato me Palermën. Dhromi më i shkurtër për Monrealin ish ai nëpër grykën e malevet Pelvum (= majë) e Saravuli mbatanë të cilëve gjëndet Malveli.

Një dhrom tjetër për Palermën, për këmbësorë e mushq, u hap herët nëpër Ayndinglë e Brinjat e fikut.

Në dimbër udhëtarët i tërboj hjima e Shën Mërisë së Boshit. Te kjo mënke shirat te moti i keq janë të përditshëm, ashtu bora e breshëri. Në fakt vendin e mësipërm të huajt, gjer më sot, e thresjën *Madona du broshiu* se në dimbër reshjet atje ngë lypsen kurrë.

Her' e herë e vërteta ë si Shën Mëria e fshehur te trualli më poshtë!



Emri


Shënim: dimbër i ftohtë, i rëndë

pritet një dimbër i ftohtë
pas dimbrit të rëndë patëm mot të mirë

Ushtrim


Çdo nyje në vendin e saj

- * moti ____ keq bie shi e zborë
- * ndenja brënda për motin ____ keq
- * na lypset ca mot ____ mirë
- * pas motit ____ mirë ra shi për një javë
- * zbara sos kur moti ____ mirë e jos
- * motit ____ keq i trëmben maçë e pleq



Një menatë me zborë

72



Kur maçja po rri te hiri, malet gdihien nga herë me zborë.

Më para se të ngryset la Gjergji merr pesë grushte bathë e i lë të njomen gjithë natën te ujët të vakët tue pritur zborën. Të flashkura zihen më mirë.

- Sa floqe të bardha ! - thotë e shoqja kur zbyll derën në mëngjes.

Lë hapët gjymsëderën e Fufi me një kërcim vete jashtë.

La Gjergji merr ca kashtë në grazhd, pret dy dru të holla (cingël lisi), çan më të trashat e të grathëtat me topëzën e i hyn te kuçina, shkalis hirin, gjen një urë e ndez zjarrin. Drutë e njoma tymojën, bathët te kudhi fryhen. Vo Lena rri te dera me duart te sytë, i shoqi pastron katoin e mushkut e vë plëht te sunduqet pér ullinjtë e Llasit. Te furriku gjen tri ve të ngrrohta e i ngrën te tanxheri. E shoqja hyn brënda, shtron tryesën e thret gjitonët. La Gjergji zë verën e kuqe te buti i vogël, e vë te tryesa e pérndan bathë të ziera te tajuret e të ardhurve.

Groshët në dimbër hahen me èndje rrëth prushit pa xixa. Bathës i mirret po bërrthama. Likurët lëhen mënjanë pér mushkun e i jipen te latira përzier me një grusht krunde. Ai nuhat erën e rrmon me thundret të jetë qeverisur nga i zoti.

Fufi, pér shërbimet e saj, po hyn e del te vëra anë derës (ghratallorja), bredh ca herë me fëmijët e, kur lodhet, pa parë mblidhet kulaç anë zjarrit.

Emri

krund/e -ja, bath/ë - a, thund/ër - ra, kasht/ë - a, dor/ë – a (duar - duart),
tryes/ë -a, bërtham/ë - a, likur/ë - a, der/ë - a (dyer-dyert)


Shënim

- A bathës së re i duhet pak të zihet
- B bathës së bluar i del krundja si grurëvet
- C bathës malore shtypi lulet
- D fara e bathës hahet si bishtajat e fasules
- E bathës së thatë i hiqet natopa me gjithë cipën
- F bathës i zë miza

Ushtrim

Gjej nyjet:

- A.1 bathës së re e të njomë i duhet pak të zihet
- B.1 bathës ___ bluar e ___ situr i del krundja si grurëvet
- C.1 bathës malore e ___ egër shtypi lulet
- D.1 fara e bathës ___ butë hahet si bishtajat e fasules
- E.1 bathës më ___ thatë i hiqet natopa me gjithë cipën
- F.1 bathës ___ thatë i zë miza



73

Lodërlanda

Lodërlanda ë një bashkësi e vogël ndër fusha e male me pak vetë: dy qen, tri maçë, katër pula, pesë dele, gjashtë butakë, shtatë miza, tetë krimba, nëntë këpushë, dhjetë breshkëza e një plak pa gojë.

Të dhënat e mësipërme gjenden te anografi i njësuar i vitit 2002, nëmos te Fletët e verdha.

Demarku i vendit ë një butak. Mosnjëri, më mirë se ai, di si rrihet në thatësirë e lagështi. Ë lulja e syut e të gjithëve.

Në Lodërländë sot ë festë e madhe: zoti Demark përruron hapjen e hidrotekës LAGEM nd'anë malit TEREM për të vegjit e gjithë bashkësisë.

Manifesti thotë:

Të nderuar Lodërländjotë,
në trembëdhjetën e sotme ju pres nd'anë malit Terem për përrimin e
hidrotekës Lagem.
Supermarket eëmbëltoret do të rrinë hapët gjer në mbrëmje në shërbim
të gjithëve.
Pije e të ngrëna ngë paguhën. Të vegjijt paçin nga një lodër, të ngrira
klëmshi e të embla sa duan.
Ju lutem të mos harroni përpjekjen e të mirrni pjesë te hapja e hidro-
tekës sonë për të mirën e tërë Bashkësisë.

DEMARKU I LODËRLÄNDËS
Hazi Butak

Nyjat

Shënim

Butaku ë lulja e syvet e të gjithëve
Anografi i bashkisë i vitit 2002 ë i njësuar



Ushtrim

Çdo nyjë në vendin e saj

- * vjet korrja e aravet (grurëvet) e moit qershori vate më mirë se simjet
- * libri i gluhiës i nxënësve të së dytës duhet botuar pa mënuar më
- * ndeshja e shqelbit e së dielës u dha dje pasngrëni në televizion
- * biblioteka e degës skollore e Horës rri hapët gjashtë ditë në javë
- * fjalën e nderit e arbëreshit mosnjëri e vë në dyshim



Koloriqi veshglatë

74

Koloriqi ë një fluturues me veti të panjohura:

- * flë me krye poshtë në vende të errëta e për muaj në dimbër
- * rrin të vegjit me sisë e ë gjallëpjellës
- * del për gjah po në mbrëmje
- * fluturon me krahë likurje.

Koloriqi na tërheq për ca tipare të tjera:

- * ka dhëmbët e ë mishngrënës
- * goja e veshët i shërbejnë si radar.

Emri i përbërë

Shënim

ndërlidhje, ultratingull, mishngrënës, gjallëpjellës, veshglatë

- A - Koloriqi në fluturim lëshon ultratinguj
- B - Te këmbët e prapme koloriqi ka pesë glishtra
- C - Koloriqi ë një fluturues mishngrënës
- D - Ndërlidhjet me satelit ndihmojn komunikacionet ndërkontinentale

Ushtrim

Në çilat fjali ndodhen fjalë të përbëra?

- A - _____
- B - _____
- C - _____
- D - _____

75

Gunthag

Asteroidët jemi plëh yjor. Lëvizja jonë në qielë është e verbër, domethënë pa orbitë. Kush vete te një anë e kush në anën tjetër.

Në gusht ca ndër ne josen në kontakt me atmosferën, po asteroidët më të mëdhenj ndoherë n'ajër ngë digjen të tërë e ngasjën rrafshin e botës.


Në tajgën e Siberisë asteroidi GUNTHAG ra pa u shkrirë.

Ne jemi plëh të imët si ai i shkretëtirës, pluhurizë në pafundësinë !

Për fat të mirë, kur hyjmëm në orbitën e botës, bëjmë pak dëm o se magnetizmi tokësor na tërheq në skajet e shkreta polare o se digjemi të tërë në kontakt me atmosferën.

Emra asnjanës

Shënim



Ushtrim

Ndaj emrat mashkullorë e femërorë nga ata asnjanës

- * të ecur-it * të ngrënë-t * brumë-t * ujë-t * dill/ë-a * mish-të
- * lesh-të * vaj-t * gjë-ja * drithë-t * klëmsh-it
- * dhjam/ë-a * të ftohtë-t * mjajt-i

M . e F.	Asnjanës
- dillé	- të ecur
-	- të ngrënë
-	- brumë
-	- ujë
-	-
-	-
-	-

Të ngrënët transgjenike

76

Elefantët, për përmasat e tyre, janë thritur pakidermë, po vetia e voglushit Mendel është njohur si elefantiasi. Në savanë ai po bën shartime, pret degë, i ngjin, thelon fryte, perime, veçon gjene e i manipulon si do.

Savana e tërë është laboratori i tij të makrobiotikës. Atje një mollë man pesë – gjashtë kile, një... Frymorët e savanës gjejën të ngrëna në sasi të mëdha, vetëm se janë transgjenike.

Një mi gjeti një arrë shtatë kilesh, e shpoi e pati të ngrënë për një muaj. Atje brënda bëri edhe folenë për të bijtë: shtatë mi. Veç dhomës së përbashkët për të ngrënët, nga një pati këndin e tij me banjo e dritare.

Emri

Shënim

të ngrënët është mirë
është hera e të ngrënët
të ngrënët i lypset kripa
jap të ngrënët pulavet
mes të ngrënët pashë një mizë

Ushtrim

Ngjit pjesët e fjalive

- | | | | |
|---|--------------------|-------------------------------------|------------------------------------|
| 1 | Në savanë | <input type="checkbox"/> | bëri dhomën e të ngrënët |
| 2 | Brënda arrës miu | <input checked="" type="checkbox"/> | gjenden të ngrëna në sasi të mëdha |
| 3 | Frymorët e savanës | <input type="checkbox"/> | hanë të ngrëna transgjenike |

77

Lodrat e Florjanës

Kur ë brënda pa mike, Florjana lot me pupat e të gjithave u dha një embër.

Njera qesh e flë, tjetra flet me zë metalik se ë jashtëtokësore.

Ajo i lan, i kreh, i vesh, i mbath, u jep të hanë e, si ngryset, i vë te shtrati.

Dje njerën _____ e la te _____ për dënim; i bëri përsheshin e ajo ngë e deshi.

E dyta, mos pij klëmshit, shturi thithin te dheu e sosi mëdhe brënda _____.

- Rri aty te të mëterrët me tët motër – i tha – se nani u los me _____ çë më huajti Valerja.

sunduqit

pupën sunduqi

pupë

Emri

*sheg/ë-a**flutur-a**dërras/ë-a**mbes/ë-a**vajz/ë-a*

njëjës

Më duhet një fshyesë për shpinë.

Një mbru fshyese e bleva me pak në treg.

Një fshyese iu çà mbruri.

Bleva një fshyesë për time shoqe.

Veç një fshyese, dje bleva ca lugë.

Shprehje

Gushti

ë fshyesë

e dimrit.

shumës

Ca fshyesa u shitën sot.

Shes mbrunjë fshyesash prej plastike.

Ca fshyesave u duhen mbrunjet e ri(nj).

Ca fshyesa të vjetra i shturën te plëhët.

Veç ca fshyesave, sot bleva një thikë.

Kujdesje !

Emrat si *zë, tru, mbru, glu,*

hu, kushëri, etj., në

formën e shquar duan

një “*r*” = *zë-r-i, mbru-r-i, etj.*

Bardhushja

78

Bardhushja leu me krahë të bardhë si lulet e kërshivet.

Leu e ra në gjumë. Në pranverë e zgjoi era e mirë e lulevet të Fushës dhe fluturimi i kandrravet e të zogavet n'ajër.

Sa bukura lule mes barit!



E tërhequr nga bukuria e tyre, Bardhushja hyri te një kupëz lulëkuqi, i la vetë brënda e me thumbin i thithi lëngun.

Një petal i lagët, me pikat të zeza të pluhurizës (shtatë sa janë notat muzikore), iu ngjit te krahët e i qëndroi ngrah si një veshje të re.

Ish qëroi i korres së barit e mikeve iu duk se u kish stolisur me të kuq për festë e prej asaj dite e thritën nuse feni.

Shënim

* Sa bukura lule!



79

Buqaqi

Buqaqi dolli jashtë
e pa një qen çë grij një asht.

Një gur mori e i shturi
e te goja gjak i buri.

Të rafshin duart – i tha një grua.
Kush ngë ka lipisi pë kafshët,
ngë ka lipisi pë mosnjeri!

Kafsh/ë-a, – ët

Ushtrim

- * Qeni ë një _____
- _____ hanë bar e mish
- Mos i bëj të lig _____

Kafshët
Kafshëvet
Kafshë

Çë thua shtu?

80

Vo Mara Gje, e vure mishët në frigo?

La Gjergji Marë, vura maçen në frigo.

Vo Mara E mishët ku e le?

La Gjergji I hyra të dy atje brënda.

Vo Mara Mjeri ti, maçja e ha mishët!

La Gjergji Mos trëmbesh se ajo ng'e ha më.

Vo Mara Si ng'e ha më? Ç'thua shtu?

La Gjergji Domëthënë se mish e maçë nani janë gjithnjë.

Vo Mara E pamundshme!

La Gjergji Nani njeri ë brënda tjetrit e rrinë bashkë si na të dy brënda shpisë.

Vo Mara Nxire jashtë, të lutem, nëmos spovis e mjera.

La Gjergji T'e nxier, t'e nxier po ti sonte, më para se të shtrosh tryesën, priru prapa te thertori në do të hamë.

Shënim

► Mjeri ti! ► të mjerët ne!

Ushtrim: gjej femëroren.

► _____ ti! ► të _____ ne!

81

Çapele e boliq

Si rrëfyejën pleqtë, një herë Hora jonë ish plotë me drangonj e loja e tyre m'e dashur ish "Çapele e boliq".

Çapelet ishën ca gurë të sheshtë mbi kodrën ç'ndan Brinjën me Sheshin.

Boliqi ish guri i Mas Marit.

Pika i vej drangoit çë me çapelen e tij, në çdo ndarje të drejtëzës, i qasej më nd'anë boliqit.



Çapelja e Drangoit

Shënim

Njëjës: një drangua, i/e një drangoi, një drangoi, një drangua, një drangoi

Ushtrim

Emra: kr/ ua- oi, përr/ ua - oi, lin/ ua - oi, th/ ua - oi, ft/ ua - oi

Shumës: ca kronje, i/e ca _____

Derri i majmë

82

Aloe ë një ari
 i rritur në borë e shi
 me mikun e tij Ant
 m'i madh se një elefant.
 O më bëjën katr'e pesë
 sytë o e shoh plotë si thes.
 Një derr i majmë me miell
 e sa ha po e viell.

derr-i, derra-t

miell-i

Ushtrim

- * ku i pe ____ me këmborë?
- * ____ i dhe lëndra o krunde?
- * më pritën si një _____
- * drithët të bluar na jep _____ e krunde
- * si janë petullat? Prej _____

derrave

mielli

derr

miell

derrat

83

Dhoqena me parghole

Për një javë e tërë Nina ngë mori më gjumë tue pritur të vejën te shpia e re.
E jëma i kish thënë:

— Te shpia e re, te ana e derës, kemi një bukur dhoqenë me një parghole
ku mënd luash pa dre me miket tote.

Kur u qas hera, vajza mjodhi lodhrat e saj e një pas një i vuri mënjanë te një
kanistër.

Mo, – i tha së jëmës – mos e lëmë më jashtë qenin ç'kemi te shpia e re nëmos
merr të ftohtë.

E jëma qeshi. Nina ngatërroi fjalën dhoqenë me qen se ish e para herë ç'e
gjegjej.

E jëma i krehu flokët me glishtarat e saj e me ëmbëlsi i tha:

— Vajza ime, u të fola vetëm për një dhoqenë, po një qen për rojë na duhet
paraç e t'e ble.

Një gëzim i madh për Ninën!

Shënim: flok-u

* floku, i/e flokut\, flokut, flokun, flokut

Ushtrim: glisht-i

* glishti, i/e glishtit ...

Dy mi

84

Dy mi, prej moti tē premtuarë, ngë martoneshën se ishën pa shpi.

Duhet t'e kërkojëm jashtë vendit – tha njeri prej tyre një natë.

Dollën e vanë Sëndastinë. Kérkuani pa prëhje, lart e poshtë, këtej e ateji. Mosgjë!

Në tē gdhirë nusja ish e lodhët e i lypi ndjesë dhëndrrit tue thënë:

Mos vemi më tutje se jam ngost.

Ai e la atje e vate përpara vetëm. E pas pak:

E gjeta, e gjeta shpinë për ne! – luriti kur pa nusen.

Gjetën një shpi e vjetër pa i zot, hyrën brënda dhe e pastruan mirë mirë.

Kur sosën, ranë tē dy mbi truall e në gjumë bërën një ëndërr tē bukur.

Në tekstin janë

Parafjalë	Ndajfolje
prej	tutje
pa	atje
_____	_____
_____	_____

85

Fara e fjalëvet

Një fëmijë gjeti një farë thjerri e e ngrëjti te një fletë fiku.

Natën ra shi e fara u lag. Kur hapi fletën, në vend të saj gjeti një garif i vogël i vogël me dy fletë për anë të vogla të vogla.

– Ku vate sosi fara? – tha i vogli me thjeshtësi.

E jëma i foli shtu: – Furnari vjen ka furri, gjaktari përllyhet me gjak, kërshia bën kërshtitë e fara bën ...

Mosgjë – tha i biri.

Jo, bën bimë të reja – shtoi e jëma – si nga kroi buron ujët.

Ushtrim

Nga fjala e parë rrjedh e dyta:

- de[j]t ■ detar
- kalë ■ calorës
- mur ■ _____
- mal ■ _____
- dele ■ _____
- mik ■ miqësi
- gjah ■ gjahtar
- i/e bukur ■ _____

Fush'Ar

86

Një herë te Hora për shtatë muaj shi ngë ra, u thajtën kronjet e bota u hap. Spovisën dele e lopë e qenëvet i dolli gluha jashtë.

Ç'ë të bëhet?

– Duhet kursyer edhe në të folurit – thanë të urtit.

– Shtu ç'ahierna Arbëreshët prenë shkurtër e në thirrjet u përdor po kryeja e fjalës: vo Le në vend të vo Lenë, vo Ke në vend të vo Kele, vo Nxhi në vend të vo Nxhishkë, la Gje ne vend të la Gjergj, etj.

Shtu vate puna e në vitin trimijë edhe Horës i ndërruan emër. E thritën Fush'Ar në vend të “Fushë e Arbëreshëvet”.

Ushtrim

Shto pjesat të prera:

- Ti re te dhe __
- Ai ra te Ho__
- U pashë një ma __
- Na vamë përjash__
- Më dhëmb një dhëm __

ni
çe
u
b
ta

87

Gjeli e miu

Një gjel me pulat e tij gjeti një bukur furriq te Guri i Lartanit e atje qëndroi.

Kur zgjonej, shplaj cepin me një pikë ujë e bëj gegalisma tue kënduar kikiriki: tri herë në çdo mëngjes.

Një menatë prapa derës pa një grumbull drithë.

- Kush m' e la ? - tha me hare e mblooi gushën. Shtu për një javë e plotë. Në fund u fsheh prapa derës e me dritën e ditës pa një mi sa një thrie ç'vej prapa e përpara tue prurë drithë.

- Ku e merr ? - i pyjeti miut. Ai qëndroi mpasmë, pranë mori frymë e foli:

E gjenj tue shkalisur te kashta e t'e jap për mirënjojhe pse ti, kudo ndodhem, më kujton të vete brënda më para se të gdihet.

U jam mi përjashtje, domëthënë mi arash e i trëmbem gjalprit. Në më zë, veç se me dërtyp si shuk, më mbyn e më jos me helmet e tij.

Më lig se të jem ngrënë ka maçet o kukrat! E njeh të thënën "maçja bredh me miun më para t'e hanj?" Ngë dua të spovis ashtu !

- E njoh. Edhe u i trëmbem dhelpres - shtoi gjeli - e për të mirën e të dyve duhet të jemi njeri për tjetrin. Kur ti sheh dhelpren, zëi një cimb te bitha o te bishti e ëm qëroin të jik.

- E ti - tha miu - kur sheh maçen shtje një thirrmë sa të jik u.

Tek ai minutë u pa vërtetë një maçe, e miu jiku.

SI VAT'E SOSI?

Miu

Gjërat me bisht

88

V M

- | | | | |
|--------------------------|--------------------------|-----------------------------|---|
| <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> 1 | Të pashë jashtë me bishtin e siut. |
| <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> 2 | Sot te zyra e postës bëra bishtin prapa gjithëve. |
| <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> 3 | Ime motër kreh flokët tufë tufë me bisht |
| <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> 4 | Djali im i bie te një pjano me bisht. |
| <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> 5 | Qeni mban bishtin nën shalë. |
| <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> 6 | Fjalët tote janë pa krye e këmbë ose pa bisht. |
| <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> 7 | Të rremet kanë bishtin kashtje. |
| <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> 8 | I nëmuri në punët e tij po i vu bishtin |
| <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> 9 | Ziejta brumit me dy bishtra lakrash |
| <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> 10 | Kush ja zë bishtin dhelpres? |

■ bisht-i, bishtra-t

Ushtrim

Shëno me një kryqe fjalitë ku bishti ë përdorur me kuptim

vetjak **V** tue lënë pa mosgjë ato me kuptim metaforik **M**

89

Glishti i vogël i Dorës

Te një festë u përpoqën Glishti i madh, Treguesi, i Mesmi e Unazori.

Ku ë Minili, i sprasmi? – pyjeti e jëma Dora të bijve – Hamë kur edhe m'i vogli do të jetë me ne te tryesa.

E gjetën përjashta në punë e me lotë te sytë.

Eja brënda – i thanë të vëllezërit me zë lutës – se mëma na do të gjithë te tryesa.

Minili, për të mirën e së jëmës, mbajti për vete fjalët q'i kishën thënë me përbuzje ca ditë më para:

– I shkurtur si je ngë na rri te ana!

Minili, pa hapur gojë, uli kryet e vate te festa me ata.

Shënim: *Glishti i vogël i dorës*

Ushtrim

- * Muaji i parë ____ vitit.
- * Vajzat e bukura ____ Horës.
- * Ditë të ftohta ____ dimrit.
- * Nuses së hjeshme ____ fshatit

i
së
të
e

I pari shi mbi botën

90

Kur Yn' Zot na bëri, gjithë patëm një vend në botë e një punë.

Ujit i tha: – *Vendi yt ë dejti e puna jote të shuash etjen e të gjallëvet. Potis farat, lulet, pemët ...*

Nje ditë ngrëjti kryet lart e pa n'ajër një luzmë mjegulla. U hap qielli e shiu po derdhej mbi male, fusha e dejt. Pishqit kërcejën të gëzuar te ujët, zogat fluturojën me cicërimë te degët e pemëvet, lulet zbylleshën gjithnjë.

Pak e pak u bërën lumet e malet u mbluan me të bardhë.

Yn'Zot pa gjithë këto bukuri, la mërinë mënjanë, nglati dorën e drejtë e me ëndje të madhe bekoi të parin shi mbi botën.

Bukuri-a, bukuri-të

Ushtrim

- * _____ e vajzavet arbëreshë ë e njojur
- * _____ e natyrës janë të ndryshme
- * Natyra ë një pasqyrë _____
- * Rreth _____ së fluturës u ka folur dhe shkruar shumë

bukuria

bukuritë

bukurish

bukurisë

91

Kafshë të egër e të butë

Te një tipografi morën me postë një shkrim olograf.

Redaktorët e zglodhën më se një herë lart e poshtë, dreq e shtrëmbër e kuptimi ish po një:

A Kali, lopa, elefanti, dhia, breshka, dhelpra, kërmilli e, me nje fjalë, gjithë barngrënësit janë kafshë të egër;

B pantera, gjalpri, liuni, gepardi e, me nje fjalë, gjithë mishngrënësit janë kafshë të butë.

U lodhën tue zgledhur. Kur sytë i vanë te radha e sprasme, fundimisht sglodhën: I nënshkruari – Bari i Sheshit. E qeshën.

Ushtrim

		barngrënës	mishngrënës
Kafshë të njojur	të butë	dele,	qen, maçe
	të egër	ljepur, ...	tigër, ...

Kush i bën e kush i gjegjet

92

Gjej lidhjet me shkak – pasojë ndër fenomenet akustike të dhënë dhe shkruaj një fjali nga një tue përdorur efektin si folje.

	Emër	Folje
1. zogë	bluarje	bluan
2. zjarr	gjëmë	gjëmon
3. qen	1 cicërim	cicëron
4. gjel	rëkim	rëkon
5. kalë	shkrepje	shkrep
6. rrufe	hingëllim	hingëllin
7. i sëmurë	3 lehje	leh
8. kukë	këndim	këndon
9. erë	vajtim	vajton
10. mulli	frymë	fryn

Fjali:

1. Zoga te dardha cicëronë ëmbëlsisht
2. Me dru e dushqe zjarri te vatra shkrep fort
3. Natën qeni po leh
4. _____
5. _____
6. _____
7. _____
8. _____
9. _____
10. _____

93

Maçja me miun tue kënduar

Maçja U jam *brënda*
 Miu U jam *jashtë*
 Maçja U jam *mbi* shtrat
 Miu U jam *nën* shtrat
 Maçja U jam e vete *ha*
 Miu U jam e vete *pi*
 Maçja U jam e *vete* ha
 Miu U jam e *vinj* e ha
 Maçja U jam e *zë* të ha
 Miu U jam e *sos* të ha
 Maçja U jam e *prëhem*
 Miu U jam e *lodhem*
 Maçja U jam e zë një *pulë*
 Miu U jam e zë një *gjel*
 Maçja U jam e zë një *mi*
 Miu U jam e zë një ...

Shtu tue bredhur maçja zuri miun e ... pranë e la.

Ushtrim

Nxir jashtë fjalitë ku kontrasti ë një emër:

■ jam e zë një pulë

Masini

94

Ca muaj prapa vam'e gjetëm një mik te spitali. Ish një ditë dimbri e dhromit me shiun u lagëm si mi.

Si na pa, Masini u gëzua aq se zuri të klaj. Edhe mua m'u njomën sytë. E jëma na priti me fjalë të mira e na haristisi për kujdesin ç'patëm për të birin kujt i dhamë një lodhër prej plastike: një pokemon.

Një herë edhe u kleva ca ditë në spital me një krahë të çarë.

Mëma e tata ngë më lanë kurrë vetëm e gjyshërat vejën e vijën si zogat te foleja.

Ngë më lanë kurrë vetëm vërtet, po më qëndroi paraç një lëmsh te zëmbra se për një javë e tërë mosnjeri te miqtë u pa.

Çdo parafjalë me emrin e saj:

* te _____

zëmbra

* me _____

shiun

* vec _____

miqe

95

Më njeh?

Jam e vogël,
një thnegël.
Në qiell jam e vetme,
të botës bijë e jashtme.
Mua buza po më qesh
e natën me dritë e vesh.
Jam e shkretë atje lart
po për gjithë jam e artë.

■ hën/ë-a

Ushtrim

- _____ ë hërnari i natës
- ulku del me _____
- ulku i leh _____

hënës

hënën

hëna

Mizat e delmerit ose xixëllonjat

96

Një herë, në mbrëmje, u ndodha te një vathë lopësh me një mik.
 Pashë ca miza zjarri e qëndrova si ntamë.
 Mora një e e mbajta ca herë te dora i tërhequr ka bukuria e saj.
 – Mos e vrit – më luriti miku i dashur e njëkohësisht më tha disa shërbise për mua pa të njohura.

Më tha se te brezi tropikal gjënden xixëllonja (eleatidet piroforine) me dy fanale për anë e se atje grat i vënë mes flokëve për zbukurim.

Një herë vate drita e me ca eleatide çë vurën brënda një qelqi, jatronjtë i nxorën një glëmb te siu një vajze.

Vetia e kandrravet xixëlluese ë drita e ftohtë.

Shëno mbiemrat të panyjshëm:

- Miku i dashur
- Shërbise të njohura
- Brezi tropikal
- Kandrra xixëlluese
- Eleatide piroforine

97

Mushëza

Leva ndër splitra te rahji i Shënjanjit. Kur isha mice o, më mirë këlyshe, një grua më dha ca klémsh te një poçe përpara derës e tue më thënë *mushëza mushëza*, pa sëhjer, e piva gjithë. Më likasi e shtu më hyri brënda.

Te shpia e vo Niqes, veç mive, gjeta gjithë buritë po për ujët të hollë e për të shkrirë jashtë edhe sot më duhet thelima. Nani flë te një shtrat i shkriftë e, si m'e mira, e zonja e shpisë më strais dy herë n'dite: me krëhrin e gjerë për qimen, me të ngushtin për pleshat.

Ajo më do si bijë. Me time motra shihem pak. E liga ë se po më thonë *llisi llisi*. Atyre ng'i shkon për krey ç'ndiejta te shpirti kur me *mushëza mushëza* lashë rahjin tim! Më mirë rrugaçë se shtu?

Ato janë motra të egra, ca njunja, ca fushtaga e biluqe. Mua kish më lëpyjën thonjtë të gjitha vetëm për klémshit ç'i lë te poçja nga mbrëma. Drudhet për mua, buka për ato. Si mënd bëhet ujë gjaku?

Motrat janë motra e i dua mirë paraç, pa mëri. Kjo ë natyra jime!

Ushtrim: për çdo emër pa të njohur të tekstit jip kuptimin e tij sipas fjalorit o sipas njohurive të pleqvet:

- splitër:
- rahj:
- këlysh:
- mic:
- plesht:
- njunj: dadun, i/e ngathët, përtaq
- fushtagë:
- poçe:
- mëri:
- biluqe: vajzë me kuptim të keq

Ndrica

98

Kur vajta e para ditë te skolla, u qepa mëmës te qafa e, tue klarë, i lutesha të mos më lëj vetëm.

– Ndri, mos u trëmb se kur del të pret jashtë mëma!

E me të vërtet për një javë po e gjeja përpara skollës me krahë të hapët, me gazin te buzët e me të puthura. Një gjëzim i madh për mua!

Një ditë ra shi me erë e mëma mënoi. Kush më këmbë e kush me makinë shokët vanë gjithë brënda me prindrat e tyre, u vetëm qëndrova atje me një mësuese. Një ditë e zezë!

– Mos trëmbesh se mëma jote ë dhromit, bie shi e duhet qëro të ...

Mëma më gjeti me lotë te sytë anë derës, më shtrëngoi fort te gjiri i saj e, si përfalje, më puthi një mijë herë.

– Të dua mirë, më tha.

U ngë fola po ata minute m'u dukën të përjetshëm, vërtet ngë sosën më.

Nxir mbiemrat nga teksti:

* i/e hapët

* i/e madh-e

* _____

* _____

99

Një letër mikut larg

Vërtet pa dru, mik, ë vatra ime e ftohtë
 e të ngrohem po shkalis hi me duar.
 Një degë e lisit u tha e bota e di.
 Sonte kujtimet jam e i ngjall me hje:
 një rri anë meje,
 ti ke afër një flutur n'erë.
 E di: në të largën Kosovë, si poet i zgjuar,
 gjithë të pritën me nder
 po për dëmet ç'pe në vend e vrasjet
 të mos harrohen dy fjalë i dua.
 Një lëmsh në grykë
 më lë pa frymë.

Në poesinë e mësipërme ë mbiemër numëror:

- të largën Kosovë
- vatra e ftohtë
- dy fjalë
- poetë i zgjuar

Një jashtëtokësor ndër ne

100

Akito udhëton larg e gjerë nëpër yj. Në oblo sheh yze në çdo pjesë të qillit. Nëj pikë e tërheq më se gjithë: një park lojtrash te bota jonë.

Vë automatikun e rrjedh atje dreq.

Fëmijët e parkut i falen me gëzim e vëhen në kontakt.

Ai flet me zë metalik po ndëlgothen paraç.

Bota ime ë e largët – thotë djali – e rrимë gjithë nën dhe të mos jemi djegur nga temperatura e zjarritë të vendit.

Të vegjëve i shkelqejën sytë tue gjegjur rrëfymin e Akitot por njize prindrat e lokalizojën në radar, e rrëmbejën mes turmës e largohen me atë çë kë me dënesë.

Në oblo shihet një dorë lart e miqtë, me lot në sy, i falen si kur t'ë kishën njojur prej vitesh.

Yll-i, yj-t

Njëjës:

Shumës:

E. një yll

ca yj

Gj. i/e një ylli

i/e ca yjve

Dh. _____

K. _____

1

Rr. _____

—

101

Pordhiliqi

Embri i tij ish Nanç po më përhaptë ish thritur Pordhiliq.

Mali polli një mi! – thanë gjitonet si e panë i vogël sa një thrie. Kush e pagëzoi shtu ngë dihet. Mirse i vogël, ish i zgjuar e i shkathët në çdo gjë.

Një ditë te Ghurghu, një xhebje me ujë amull në qafë të mullirit më poshtë, ra një vajzë çë vate atje për lule. Gjithë lurijën po mosnjeri prori mëngët në ndihmë të saj. Nançi gjegji thirrmat e rrođhi. U shtu bakar n' ujë, e nxori jashtë e, si e pa e zalisur, gojë më gojë i dha frymën.

Kush thotë se e mori për mesi, kush për kripni e kush nën sjetull.

Vajza ish'e bija e demarkut të Horës. Mbijetoi e, si te një endërr, po kujtoj se atë ditë u ndie puthur te buzët ka djali i zëmbrës. Si u rritën të dy, u martuan me hajdhi të mëdha e, pas kurorës, për trashëgim patën bij jo vetëm të shëndetshëm e të fuqishëm po edhe të glet e të bukur.

Ushtrim: për çdo emër pa të njojur të tekstit, jip kuptimin e tij sipas fjalorit o sipas njojurive të pleqvet:

- thrie:
- i/e shkathët
- xhebje
- amull: ujë të ndenjur
- thirrmë
- bakar: zogë pa qime e pa pendë
- sjetull:
- demark: kryetar i bashkisë
- trashëgim:
- i/e shëndetsh-ëm/me

Shqiponje bir

102

Re u bëre
 shoqe të erës,
 shqip-o një shqiponje
 bir, Vore.
 Vore a frys e rreptë.
 Pulini
 të birin thret
 ujk tashmë
 pa zë.
 Nga veriu lundron
 në jug një pëlbur'e bardhë
 gjatë Drinit
 të zi.

Gjej sintagmat si:

* Vore a frys

* Pulini thret

* _____

* _____

103

Të vjelat te Hora e Arbëreshëvet

DHRI	A	
R	R	USH
	B	UT
G	Ë	RSHËRË
R	R	EMB
RR	E	MPUJ
VRE	S	HTË
MUS	H	T
...	Ë	

lastar
 përpajnë
 vjelje
 hu
 vucë
 shartim
 pipë
 dhri
 çerr
 linua
 shtrydhës
 parghole
 vreshtë
 verë
 stok

Shkruaj ca fjali rrreth temës:

- dhritë lidhen vetë te huri me çerret e tyre.
- rrushi vilet me gérshërë.
- një herë rrushi shtypej me këmbë te linoi.
- lastarët shartohen me sythe, pipa e njomëza të buta.
- U piva një qelq verë të bardhë, ti një kënata e tërë të kuqe.
- Simjet burra gjashtë bute verë me rrush pirrikuni e katarrati.

- _____
- _____
- _____
- _____
- _____
- _____

Udhëtim me alfabetin shqip

104

- B** Bathë, besë, bëndje, bir, bjeshkë, byk, botë, bukë
- C** Cakan, cep, cëpëz, cimb, cjap, cyle, copë, cusk
- D** Dash, derr, dëm, dimër, djebë, dymbëdjetë, dorë, dushk
- Dh** Dhastër, dhe, dhëmb, dhi, dhjamë, [dhy ...], dhomë, dhunë
- F** Farë, fendë, fëmijë, fik, fjalë, fyell, floqe, fund
- Gj** Gjak, gjel, gjëmë, gjizë, gjysh, gjon, gjumë
- L** Lakër, lesh, lëmë, lis, ljepur, lypës, lopë, lule
- M** Mal, menjë, mëz, mizë, mjajt, mysliman, morr, mut
- P** Patë, pelë, përrua, pile, pjesë, pyllë, poçe, pulë

Ca fjalë me:

A	Arbëresh, arrë, akrep	R	
Ç	Çapele, çam,	RR	
E		S	
Ë		SH	
G		T	
H	Himarjot,	TH	
I		U	
J		V	
K		X	
LL		XH	
N		Y	
NJ		Z	
O		ZH	
Q		HJ	Hjaravol,

105

Varre n'ujë

Humbën në det
 të ndjerët,
 larg vendit të tyre humbën.
 Ikën e vdiqën të mjerët.
 Viset e lindjes dhe ne
 i braktisëm
 një herë
 e prindët lamë me dënesë.
 Sa vdiqën në det ?
 Një... një mijë... kush e di !
 Për të gjithë
 pethkat e lipit veshëm
 e më s'i kemi nxjerrë
 por varre n'ujë hapen prapë
 me të vdekur.

Ushtrim

* Sa vetë vdiqën në det?

* në det vdiqën _____ vetë

* në det vdiqën _____ vetë

* në det vdiqën _____ vetë

një, dy, tri, katër, pesë, gjashtë, shtatë, tetë, nëntë, dhjetë, qind, mijë

I vëllai i mikut tim

106

I vëllai i mikut tim vete tek e para. Mësuesja i la një dëtyrë për brënda e i tha: _ Zografis një vathë pa elemente, një me dy, me katër, gjashtë, tetë, dhjetë elemente.

I vogli bëri gjashtë vatha: tek e para zografisi një pishk, tek e dyta një zogë, tek e treta një qen, tek e katërtë një mizë, tek e pesta një rriqër e tek e sprasmja një purp.

Mësuesja i mori fletoren e i bëri vërejtjet e saj:

- Kjo punë ë bërë më këmbët, tha ajo, se në çdo vathë shoh po një element.
- Si, tha nxënësi, sheh po një element! Tek e para çë sheh?
- Një pishk!
- E sa këmbëza i sheh pishkut, zonja mësuese?
- Asnjë!, tha ajo.
- Asnjë për mua ë xero e pishku ë pa këmbë o jo?

Mësuesja qeshi, nxënësi mori fletoren e vate te vendi i tij.

Pishku ë pa këmbë, zoga ka dy, qeni katër, miza gjashtë, rriqëra tetë e purpi dhjetë.

Shënim

$2+1=3$	[dy edhe një bën tre]	$6:3=2$	[gjashtë ndarë për tre bën dy]
$3-1=2$	[tre pa një bën dy]	$\frac{1}{2}$	[një gjymës, një n'dysh]
$2 \times 3=6$	[dy herë tre bën gjashtë]	$\frac{3}{4}$	[tri të katërtat]

Ushtrim: me letra

$5+2=7$	[dy edhe një bën tre]	$8:2=4$
$4-1=3$		$\frac{1}{4}$
$2 \times 5=10$		$\frac{5}{8}$

“udhëtimi”



Gramatika
Pjesa e dytë

Te pasijata “8 Mars”



- U *jam* Mara e ti kush *je* ?

- U *jam* Marku e kjo *ë* Lia: na *jemi* miq.

- *Jini* miq ?! Ngë *jini* nuse e dhëndër ?

- Jo, *jemi* vetëm miq !

Pali e Kelja *janë* nuse e dhëndër !

Vërejtje: “*jam, je, ë, jemi, jini, janë*” *janë* vetat e kohës së tashme të menyrës dëftore të foljes “*jam*”.

Folja *jam*

Mënyra dëftore

Koha e tashme

Njëjës	Shumës
<i>u jam</i>	<i>na jemi</i>
<i>ti je</i>	<i>ju jini</i>
<i>ai ë</i> (isht, është)	<i>ata janë</i>

Ushtrime

Vér folien *jam* në formën që duhet:

- 1 - Lia, Mara, Mena, Kelja, Vitorja e Marieja _____ mike.
- 2 - Na _____ miq të vjetër.
- 3 - Ajo vajzë kështu e bukur kush _____?
- 4 - Ata djem këtje kush _____?
- 5 - Ata djem _____ miq tim.
- 6 - _____ e hollë si purtekë, bija jime!
- 7 - Tek e diellja u _____ Palermë.
- 8 - Sot _____ e martja o e mërkurja?
- 9 - U _____ e shkurtur, ma ti ngë _____ më e glatë se u.
- 10 - Ju _____ kriendulla o _____ të mëdhenj ?

Ke skollë somenatë ?

2

Vitorja një ditë *ka* dhëmbje te kryet, një ditë *ka* këmbët të rënda, një ditë sytë i *kanë* mjegulla, një ditë *ka* këtë e njetër ditë *ka* atë ! Përçë ? Përçë nga menatë, nxjerrë të dielljën, *ka* skollë !

E jëma: - Vitorja, çë *kemi* te kudhi somenatë: *ke* o ngë *ke* skollë !?

Vitorja: - *Kam*, mo' ! Më lig se *kam* edhe dhëmbje te glishrat !

E jema: - Mirë, mirë ! E miket tote, edhe ato *kanë* gjagjë nga menatë kur *kanë* skollë ?

Vitorja: - Jo, ato ngë *kanë* gjë, po u i *kam* dhëmbjet kur *kam* skollë !

E ju, djem e vajza, *kini* skollë somenatë ?

Vërejtje: *kam*, *ke*, *ka*, *kemi*, *kini*, *kanë* janë format e *kohës së tashme* të mënyrës *dëftore* të foljes *kam*.

Folja *kam*

Menyra dëftore

Koha e tashme

Njëjës	Shumës
<i>u kam</i>	<i>na kemi</i>
<i>ti ke</i>	<i>ju kini</i>
<i>ai ka</i>	<i>ata kanë</i>

Ushtrime

Vér foljen kam në formën që duhet:

- 1 - Marku e Gjergji _____ një bicikletë për nga një.
- 2 - Lia _____ një lule te kriptë.
- 3 - Menë, çë _____ te dora?
- 4 - U _____ një rrashkun te dora.
- 5 - Mara e Serafina _____ gjumë.
- 6 - Na te shpia jonë _____ dy kompiutere e ju sa _____?
- 7 - Na _____ po një kompiuter e ju e _____ antenën parabolike?
- 8 - U _____ po një vëlla e ti sa _____?
- 9 - Disa herë, kush _____ bukën ngë _____ drutë e kush _____ drutë ngë _____ bukën!
- 10 - Mirela, _____ një rrigall për tyj.

3

T' ujur te hjeja

I NIPI - Noni, çë lodra *kishe* i vogël ?

NONI - Një herë, kur *kisha* tetë vjeç, si rrígall pata një balun. Mosnjeri te Hora *kish* ahierna një balun ashtu të madh ! Te Hora, si ku isht isht, me të vërtetë *patëm* qëronje të ligj; thuajse ngë *kishëm* manku bukën e përditshme!

I NIPI - E si e *pate* atë rrígall, në te shpia *kishët* probleme ?

NONI - Rrigallin e *pata* ka një djalë lëti çë *kish* shpinë te Hora.

I NIPI - Miqtë tat çë lodra *kishën* ?

NONI - Ngë *kishëm* ndutu gjë: një *kish* një kamion të vogël bërë me dërrasa; njetër *kish* një kaçapet; ma tjerët ngë *kishën* gjë.

I NIPI - Te gjiria jote *patët* kurrë rrígaje lodrash?

NONI - Jo, ngë i *patëm*.

I NIPI - E miqtë tat i *patën* kurrë ?

NONI - Jo, mosnjeri i *pati*.

Vërejtje

A

“*kisha, kishe, kish, kishëm, kishët, kishën*” janë format e *kohës së pakryer* të mënyrës dëftore të foljes *kam*.

B

“*pata, pate, pati, patëm, patët, patën*” janë format e *kohës së kryer* të *thjeshtë* të mënyrës dëftore të foljes *kam*.

Folja *kam*

Mënyra dëftore

Koha e pakryer

u kisha
ti kishe
ai kish

na kishëm
ju kishët
ata kishën

Njës
Shumës

Koha e kryer e thjeshtë

u pata
ti pate
ai pati

na patëm
ju patët
ata patën

Njës
Shumës

Ushtrime

Vër format që duhen të së pakryerës të foljes *kam*.

- 1 - Na *kishëm* po një biçikletë.
- 2 - Noni e nona _____ po një vajzë.
- 3 - Ti e _____ nusen?
- 4 - Ju, vajza, _____ një libër pullaresh.
- 5 - Marku _____ frevën.
- 6 - U e _____ një herë një mik liti.

Vër format që duhen të së kryerës së thjeshtë të foljes *kam*.

- 1 - Na *patëm* po një biçikletë.
- 2 - Noni e nona _____ po një vajzë.
- 3 - Ti e _____ nusen ?
- 4 - Ju, vajza, _____ një libër pullaresh.
- 5 - Marku _____ frevën.
- 6 - U e _____ një herë një mik liti.

4

Përpara skollës “Skënderbe”

LUKA - Kur *isha* i vogël u, *ishe* e vogël edhe ti:
të dy *ishëm* të vegjij!

LIA - Ti e jyt vëlla *ishët* të vegjij ! U *isha* e madhe
si *ish* e madhe jime motër. Edhe jime kushërirë *ish* e
madhe.

LUKA - Jot motër e jot kushërirë ngë *ishën* të
mëdha, *ishën* edhe ato të vogla.

MARA - Ku *kleve* te kjo shtazhunë?

MARKU - *Kleva* te dejti. E ti ?

MARA - Mëma, tata, jime motër e u *klemë*
Romë. Ju *kletë* kurrë Romë?

MARKU - U jo, ma i *kle* tata e i *klenë* edhe
nonërat.



Vërejtje

A
“*isha, ishe, ish, ishëm, ishët, ishën*” janë format e *kohës së pakryer* të menyrës dëftore të foljes *jam*.

B
“*kleva, kleve, kle, klemë, kletë, klenë*” janë format e *kohës së kryer* të thjeshtë të mënyrës dëftore të foljes *jam*.

Folja *jam*

Mënyra dëftore

Koha e pakryer

u isha
ti ishe
ai ish

Njëjës

na ishëm
ju ishët
ata ishën

Shumës

Koha e kryer e thjeshtë

u kleva
ti kleve
ai kle

Njëjës

na klemë
ju kletë
ata klenë

Shumës

Shënim: E kryera e thjeshtë shqipe si edhe ajo e disa horëve të tjera arbëreshe bën: *qeshë, qe, qe, qemë, qetë, qenë*.

Ushtrime

Vér format që duhen të së pakryerës të foljes *jam*.

- 1 - Ju ishët të fortë vjet te baluni.
- 2 - Mara e Mena _____ te kopshti pér lule.
- 3 - Vito, ti _____ një djalë i mirë i vogël.
- 4 - U _____ te skolla.
- 5 - Lia e u një muaj prapa _____ pérjashta.
- 6 - Nona _____ një grua e bukur.

Vér format që duhen të së kryerës së thjeshtë të foljes *jam*.

- 1 - Ju kletë të fortë vjet te baluni.
- 2 - Mara e Mena _____ te kopshti pér lule.
- 3 - Vito, ti _____ një djalë i mirë i vogël
- 4 - U _____ te skolla.
- 5 - Lia e u një muaj prapa_____ pérjashta.
- 6 - Nona _____ një grua e bukur.

5

Mbrëmanet te shpia

E JËMA - Marë, kur *ka jesh* më me tru e *ka kesh* mendim për studjet ?

E BIJA - Mo', kur *ka jem* me tru u, *ka kem* tetëmbëdhjetë vjeç !

E JËMA - Ah, kjo djalëri e sotme: kur *ka e ketë* një thërrime dhukacionë e *ka jetë* më e butë !

E BIJA - E ju të mëdhenj, kur *ka e kini* një thërrime kunsideracionë për ne fëmijë e *ka jini* më të ëmbël?

E JËMA - Kunsideracionë ? *Ka kemi* më shumë se sa kemi ?! E *ka jemi* më të ëmbël se sa jemi?! *Ka e kenë* edhe fëmijët kunsideracionën për ne, e *ka jenë* të ëmbël edhe ata me ne prindra!

Vërejtje

A

“*ka kem, ka kesh, ka ketë, ka kemi, ka kini, ka kenë*” janë format e kohës së ardhshme arbëreshë të foljes *kam*. Arbërisht ndodhet edhe kjo formë: “*do kem, do kesh, do ketë, do kemi, do kini, do kenë*”.

B

“*ka jesh, ka jem, ka jetë, ka jemi, ka jini, ka jenë*” janë vetat e kohës së ardhshme arbëreshë të foljes *jam*. Arbërisht ndodhet edhe kjo formë: “*do jem, do jesh, do jetë, do jemi, do jini, do jenë*”.

Mënyra dëftore

Koha e ardhshme

Folja *kam*

<i>Njëjës</i>	<i>u</i> ka kem
<i>Shumës</i>	<i>ti</i> ka kesh
	<i>ai</i> ka ketë
	<i>na</i> ka kemi
	<i>ju</i> ka kini
	<i>ata</i> ka kenë

Folja *jam*

<i>Njëjës</i>	<i>u</i> ka jem
<i>Shumës</i>	<i>ti</i> ka jesh
	<i>ai</i> ka jetë
	<i>na</i> ka jemi
	<i>ju</i> ka jini
	<i>ata</i> ka jenë

Ushtrime

Duke përdorur të dy format “ka...” e “do...”, prir në kohën e ardhshme të foljes “kam”, këto fjali që ndodhen në kohën e tashme.

- 1** - Vitorja ka një biçikletë të kuqe, si rrígall (dhuratë).
 - Vitorja ka ketë një biçikletë të kuqe, si rrígall (dhuratë).
 - Vitorja do ketë një biçikletë të kuqe, si rrígall (dhuratë).
- 2** - Marku e Vito kanë një balun të madh.
 - Marku e Vito _____ një balun të madh.
 - Marku e Vito _____ një balun të madh.
- 3** - Sara, ti ke fat të mirë te gjella !
 - Sara, ti _____ fat të mirë te gjella !
 - Sara, ti _____ fat të mirë te gjella !
- 4** - Ju e kini një mik si u ?
 - Ju _____ e _____ një mik si u ?
 - Ju _____ e _____ një mik si u ?
- 5** - U kam një nuse arbëreshe.
 - U _____ një nuse arbëreshe.
 - U _____ një nuse arbëreshe.
- 6** - Na ngë kemi skollë të shtunë.
 - Na ngë _____ skollë të shtunë.
 - Na ngë _____ skollë të shtunë.

Duke përdorur të dy format “ka...” e “do...”, prir në kohën e ardhshme të foljes “jam”, këto fjali që ndodhen në kohën e tashme.

- 1** - Lia, ti je më e bukura e gjithëve !
 - Lia, ti _____ më e bukura e gjithëve !
 - Lia, ti _____ më e bukura e gjithëve !
- 2** - Mara e Kele, ju jini të parat e skollës.
 - Mara e Kele, ju _____ të parat e skollës.
 - Mara e Kele, ju _____ të parat e skollës.
- 3** - Mena ë një vajzë e mirë.
 - Mena _____ një vajzë e mirë.
 - Mena _____ një vajzë e mirë.
- 4** - Vito, Mara e Mena janë miq për gjithë gjellën.
 - Vito, Mara e Mena _____ miq për gjithë gjellën.
 - Vito, Mara e Mena _____ miq për gjithë gjellën.
- 5** - Kelja e u jemi të lumtur.
 - Kelja e u _____ të lumtur.
 - Kelja e u _____ të lumtur.
- 6** - Lenë, po u jam dhëndri jyt !
 - Lenë, po u _____ dhëndri jyt !
 - Lenë, po u _____ dhëndri jyt !

6

Ka Shënjanji

Bukur ë kur *shkonj* ka Shënjanj sa dielli *perëndon* aprapa malevet e *dërgon* rrezet mbi ca mjegulla çë *shkëlqejën* të kuqe si kërshi.

Edhe shpitë, rrugët, kopshtet janë të kuqe, edhe lisat e njerëzit janë të kuq.

Ti rron ata pak minute të perëndimit si në ëndërr: natyra të *mblon* zëmrën me zjarr, se pra njize *rrotullojën* në quell mbrëmja e nata.

Ma prapa natës të gjithë *kérkojëm* pameta dritën e dielli.



Vërejtje

Foljet “*shkonj, perendon, dërgon, shkëlqejën, rron, mblon, rrotullojën, kérkojëm*”, janë forma të kohës së tashme të mënyrës dëftore të zgjedhimit të parë.

ZGJEDHIMI I PARË

Folja *kérkonj*

Mënyra dëftore
Koha e tashme

Njëjës

u kérkonj
ti kérkon
ai kérkon

Shumës

na kérkojëm
ju kérkoni
ata kérkojëm

Si *kérkonj* zgjedhohen të gjitha foljet e tjera që dalin me *-o-nj* (*shkonj, dërgonj, rronj, mblonj, rrotullonj*, ...).

Si foljet që dalin me *-o-nj*, zgjedhohen edhe foljet që dalin me *-e-nj* (*rrëfyenj, shkëlqenj*) , me *-a-nj* (*shkruanj*), me *-i-nj* (*fshinj*), me *-ë-nj* (*bënj*), me *-y-nj* (*hynj*).

Ushtrime

Plotëso format e këtyre foljeve me mbaresat që duhen:

1) Veta e tretë e numrit njëjës e foljes **bënj**:

bën .

2) Veta e tretë e numrit shumës e foljes **shkruan**:

*shkrua*_____.

3) Veta e dytë e numrit njëjës e foljes **fshinj**:

*fshi*_____.

4) Veta e parë e numrit njëjës e foljes **shkruan**:

*shkrua*_____.

5) Veta e dytë e numrit shumës e foljes **dërgonj**:

*dërgo*_____.

6) Veta e parë e numrit shumës e foljes **rronj**:

*rro*_____.

7) Veta e tretë e numrit njëjës e foljes **hynj**:

*hy*_____.

8) Veta e parë e numrit shumës e foljes **lanj**:

*la*_____.

9) Veta e dytë e numrit shumës e foljes **ndenj**:


*nde*_____.

10) Veta e tretë e numrit shumës e foljes **dërgonj**:

*dërgo*_____.

7

Te Gamili



- Të *pres* te Gamili me bicikletën e pra *marrjëm* stratën e Purteles: më parë *rrjedhjëm* te pujata e pra te shinuta.

- U *thërres* Marën, ajo *flet* me Sarën, *marrjëm* bicikletat e kush arrën i pari te Gamili *pret*.

Bukur vend Gamili !

Ka Gamili ke përposh syvet një pjesë të madhe të Horës: lijeni *merr* thuajse gjithë fushën, honi *pret* malin Maganuç ka mali Kumeta, Maganuç *shket* te lijeni e syu jynë *kumbis* thuajse mbi ujërat atë shpatull të Kumetës, çë *jep* mbi honin.

Ka Gamili *sheh* edhe Sëndastinën, më llargu *sheh* malet Madonie e më atej se honi *njeħ*, nē *hap* mirë sytë, edhe Kundisën. Bukur vend ë Gamili!

Vërejtje

foljet “*pres, marrjëm, rrjedhjëm, thërres, flet, pret (prita), merr, pret (preva), shket, kumbis, jep, sheh, njeħ, hap*”, janë veta të kohës së tashme të mënyrës dëftore të zgjedhimit të dytë.

ZGJEDHIMI I DYTË

Te zgjedhimi i dytë bëjnë pjesë të gjitha foljet që dalin, te veta e parë e kohës së tashme të dëftores, me ndonjë *bashkëtingëllore* (-b, -dh, -h, -k, -l, -p, -q, -r, -rr, -s, -sh, -z, ...):

<i>trëmb,</i>	<i>jap,</i>	<i>flas,</i>
<i>rrjedh,</i>	<i>heq,</i>	<i>thërres,</i>
<i>njoh,</i>	<i>marr,</i>	<i>kumbis,</i>
<i>pjek,</i>	<i>nxier e nxjerr,</i>	<i>shosh,</i>
<i>vjel,</i>	<i>pres (preva),</i>	<i>dhez e ndez,</i>
<i>hap,</i>	<i>pres (prita),</i>	<i>etj.</i>

Menyra dëftore
Koha e ardhshme

Folja hap

Njëjes

u hap
ti hap
ai hap

Shumës

na hapjëm
ju hapni
ata hapjën

Folja pres

Njëjes

u pres
ti pret
ai pret

Shumës

na presjëm
ju princi
ata presjën

Shembuj

Njëjes

u njoh
ti njeh
ai njeh

Shumës

na njohjëm
ju njihni
ata njohjën

Folja njoh

Njëjes

u marr
ti merr
ai merr

Shumës

na marrjëm
ju mirrni
ata marrjën

Folja marr

Si **hap** zgjedhohen te numri njëjes i kohës së tashme të mënyrës dëftore: rrjedb, trëmb, vjel, heq, kumbis, dhez e ndez, ...

Si **pres** zgjedhohen: thërres, shes, flas (ti, ai flet), ngas (ti, ai nget), shkas (ti, ai shket), vras (ti, ai vret), ...

Si **njoh** zgjedhohet, për shembull, “shoh”, çë bën pjesë te foljet e parregullta.

Si **marr** zgjedhohet, për shembull, edhe “jap”: *jap, jep, jep, japjëm, jipni, japjën*.

Ushtrime

Plotëso format e këtyre foljeve me mbaresat që duhen:

1) Veta e dytë e numrit njëjës e foljes pres:

pre t .

2) Veta e tretë e numrit shumës e foljes marr:

marr ____ .

3) Veta e dytë e numrit njëjës e foljes rrjedh:

rrje ____ .

4) Veta e dytë e numrit njëjës e foljes shoh:

sh ____ .

5) Veta e dytë e numrit shumës e foljes shkas:

shk ____ .

6) Veta e dytë e numrit njëjës e foljes jap:

j ____ .

7) Veta e tretë e numrit njëjës e foljes shkas:

shke ____ .

8) Veta e tretë e numrit njëjës e foljes thérres:

thérre ____ .

9) Veta e dytë e numrit shumës e foljes marr:

mirr ____ .

10) Veta e dytë e numrit shumës e foljes pres:

pri ____ .


Te Shën Mëria e Dhitrjes

8

Kush zë dhromin e malit Picuta e *vete* lart te Shën Mëria e Dhitrjes, *di* se ajo ë rruga mali më e vjetër e Horës. Kur jini atje lart, *vëni* re se klishëza *rri* bukur te rrëzat e Picutës: t' Atërat tanë patën sy të mirë !

Te moi i gushtit, si menatnet njize i *bie* kambana e klishëzës, na *vemi* te mesha me tjerët besimtarë. Nga Shën Mëria e Dhitrjes kemi përpara të lerit e diellit. E ë bukur kur besimtarët, sosur mesha, *zënë* fill këngat e kujtimit për Shqipërinë e Morenë (E bukura More'!), çë *rrinë* këtje llargu më atej se malet e malevet, më atej se dejti.

Dielli nanì *shtie* rrezet e tij mbi klishëzën e na *zëmë* fill njetër ditë.



Vërejtje

Foljet “*zë, vete, di, vëni, rri, bie, vemi, zënë, rrinë, shtie, zëmë*”, janë forma të *kohës së tashme* të mënyrës dëftore të zgjedhimit të tretë.

ZGJEDHIMI I TRETË

Te zgjedhimi i tretë bëjën pjesë të gjitha foljet që dalin, te veta e parë e *kohës së tashme* të dëftores, me ndonjë zanore (-a, -e, -ë, -i : *ha, bie, vete, lë, vë, zë, di, pi, rri, ...*)

Shembuj

Folja zë

Mënyra dëftore
Koha e tashme

Njëjës	u zë
	ti zë
	ai zë
Shumës	na zëmë
	ju zëni
	ata zënë

Si zë zgjedhohen në kohën e tashme të mënyrës dëftore: zë, vë, lë, di (ti, ai di; na dimë, ju dini, ata dinë), rri (ti, ai rri; na rrëmë, ju rrini, ata rrinë), ha (ti, ai ha; na hamë, ju hani, ata hanë),

Njëjës	u bie
	ti bie
	ai bie
Shumës	na biem
	ju bini
	ata bien

Si bie zgjedhohet folja “shtie”.

Folja vete

Mënyra dëftore
Koha e tashme

Folja bie

Mënyra dëftore
Koha e tashme

Njëjës	u vete
	ti vete
	ai vete
Shumës	na vemi
	ju veni
	ata venë

Ushtrime

Plotëso format e këtyre foljeve me mbaresat që duhen:

1) Veta e parë e numrit shumës e foljes lë:

lë më .

2) Veta e tretë e numrit shumës e foljes ha:

ha .

3) Veta e dytë e numrit shumës e foljes pi:

pi .

4) Veta e dytë e numrit njëjës e foljes shtie:

shti .

5) Veta e dytë e numrit shumës e foljes shtie:

shti .

6) Veta e dytë e numrit shumës e foljes di:

di .

7) Veta e tretë e numrit shumës e foljes di:

di .

8) Veta e tretë e numrit njëjës e foljes rri:

rri .

9) Veta e dytë e numrit shumës e foljes vete:

vete .

10) Veta e tretë e numrit shumës e foljes vete:

vete .

9

Guri i Mas-Mares, Guri i të (së) Mjerës-Marë, o Guri i Mas-Marit?



Një herë përpoqa një plak që më foli pë' "Gurin e mas-Mares" o "Gurin e së Mjerës Marë", o si *thëshëj* ai, "Gurin e mas-Marit", çë ë një guri, o më mirë një shkëmb, çë *ra* ka mali Picuta e *jerdhi* e *sosi* poshtë te fusha.

Ai plak më *rrëfyej* se te qeronjet e shkuar, ku sot ë guri, *rridhëj* një lum i vogël, një përrua, ku gratë *vijën* e *lajën* pethkat.

- Në *vijën* gratë të *lajën* pethkat, kush e *thërriti* "Guri i Mas- Mares", kish ligj !

Plaku ndërçë *hapëj* krahët *tha*:

- Ashtu thomse, ma njetër rrëfim *jipëj*

njetër version: se aty ku nanì ë guri, *vij* e *shërbej*, kush e di përcë, një burrë, një mjeshtër këpucësh, një këpuçar, çë i *thëshjën* mas- Mëri, e kur guri rrotulloi ka mali e *vuri* prëposh.

- Më i drejtë jetri rrëfim ë !

- Ai i gruas ? Eh, një ditë ca gra *jerdhën* e *lajtën* pethkat, por papritur mjegullat *mbluan* qielljën; si *zunë* fill të bijën të parat pika të trasha shiu, gjithë gratë *rrodhën* te shpitë e tyre, por njera, ajo Marë, *ndëlgoj* se ishën mjegulla çë *shkojën* e *vejën* e ashtu *qëndroi* atje buzë lumi. *Shtrëngoi* e thomse shiu *shkuli* ka mali shkëmbin, çë *rrotulloi* me fuqi të tmerrshme njera te ku ish ajo Marë e e *vuri* përposh, të mjerën!

- "Të mjerën", the ! Atëherë kush *rrëfyejti* se ky gur ish "Guri i të mjerës Marë" kish më ligj se gjithë !

A

Vërejtje

Foljet e shëmuara në kohen e pakryer të dëftores janë:

- 1) Të zgjedhimit të parë (që në kohën e tashme të dëftores dalin me -onj, -anj, -enj, -inj): rrëfyej (rrëfyenj), vijën (vinj), lajën (lanj), vij (vinj), shërbej (shërbën), ndëlgjoj (ndëlgonj), shkojnë (shkonj).
- 2) Të zgjedhimit të dytë (që në kohën e tashme të dëftores dalin me bashkëtingëllorre): rridhëj (rrjedh), hapëj (hap), jipëj (jap).
- 3) Të zgjedhimit të tretë (që në kohën e tashme të dëftores dalin me zanore) ë: vejën (vete).

ZGJEDHIMI I PARË

Folja shkonj

Mënyra dëftore
Koha e pakryer

Njëjës	<i>u</i> shkoja <i>ti</i> shkoje <i>ai</i> shkoj
Shumës	<i>na</i> shkojëm <i>ju</i> shkojët <i>ata</i> shkojnë

Si **shkonj** zgjedhohen gjithë foljet e zgjedhimit të parë : (kérkonj) kérkoja, kérkoje, kérkoj,...; (lanj) laja, laje laj, ... ; (rrëfyenj) rrëfyeja, rrëfyeje, rrëfyej, ... ; (vinj) vija, vije, vij, ... ; etjera .

Folje të parregullta në kohën e pakryer:
“da(lë)nj”: dilja, dilje, dilëj, diljëm, diljët, diljën.

ZGJEDHIMI I DYTË

Folja hap

Mënyra dëftore
Koha e pakryer

<i>Njëjës</i> <i>Shumës</i>	<i>u</i> hapja <i>ti</i> hapje <i>ai</i> hapëj <i>na</i> hapjëm <i>ju</i> hapjët <i>ata</i> hapjën
------------------------------------	---

Si **hap** zgjedhohen gjithë foljet e zgjedhimit të dytë : (*përpjek*) *pérpiqja*, *pérpiqje*, *pérpiqëj*, *pérpiqjëm*, *pérpiqjët*, *pérpiqjën*; etjera.

Folje të parregullta në kohën e pakryer:

flas: *flisja*, *flisje*, *flisëj*, *flisjëm*, *flisjët*, *flisjën*.

jap: *jipja*, *jipje*, *jipëj*, *jipjëm*, *jipjët*, *jipjën*.

marr: *mirrja*, *mirrje*, *mirrëj*, *mirrjëm*, *mirrjët*, *mirrjën*.

njoh: *njihja*, *njihje*, *njhëj*, *njihjëm*, *njihjët*, *njihjën*.

rrjedb: *rridhja*, *rridhje*, *rridhëj*, *rridhjëm*, *rridhjët*, *rridhjën*.

shob: *shihja*, *shihje*, *shihëj*, *shihjëm*, *shijët*, *shihjën*.

thom: *thëshja*, *thëshje*, *thëshëj*, *thëshjëm*, *thëshjët*, *thëshjën*;

edhe: *thoshja*, *thoshje*, *thoshëj*, *thoshjëm*, *thoshjët*, *thoshjën*.

pres: *prisja*, *prisje*, *prisëj*, *prisjëm*, *prisjët*, *prisjën*.

vdes: *vdisja*, *vdisje*, *vdisëj*, *vdisjëm*, *vdisjët*, *vdisjën*.

ZGJEDHIMI I TRETE

Folja zë

Mënyra dëftore
Koha e pakryer

<i>Njëjës</i>	<i>u</i> zëja <i>ti</i> zëje <i>ai</i> zëj
<i>Shumës</i>	<i>na</i> zëjëm <i>ju</i> zëjët <i>ata</i> zëjën

Si **zë** zgjedhohen gjithë foljet e zgjedhimit të tretë:

- (dua) *deja, dejë, dej, dejëm, dejët, dejën;*
- (ha) *haja, haje, haj, hajëm, hajët, hajën;*
- (lë) *lëja, lëje, lëj, lëjëm, lëjët, lëjën;*
- (vete) *veja, veje, vej, vejëm, vejët, vejën.*

B Vërejtje

Foljet e shënuara te rrëfymi më sipër në të kryerën e thjeshtë të dëftores janë:

- 1) Të zgjedhimit të parë (që në *kohën e tashme* të dëftores dalin me *-onj, -anj,*): *jerdhi e jerdhën* (të parregullt nga *vinj*), *rrotulloi* (*rrotullonj*), *lajtën* (*lanj*), *mbloï* (*mblonj*), *qëndroi* (*qëndronj*), *shtrëngoi* (*shtrëngonj*), *rrëfyejti* (*rrëfyenj*).
- 2) Të zgjedhimit të dytë (që në *kohën e tashme* të dëftores dalin me *bashkëtingëllorre*): *përpjek*, *foli* (*flas*), *sosi* (*sos*), *thërriti* (*thërrres*), *tha* (*thom*), *rrodhën* (*rrjedh*), *shkuli* (*shkul*).
- 3) Të zgjedhimit të tretë (që në *kohën e tashme* të dëftores dalin me *zanore*) janë: *ra* (i parregullt nga *bie*), *vuri* (*vë*), *zunë* (*zë*).

ZGJEDHIMI I PARË

Folja qëndronj

Mënyra dëftore
Koha e kryer e thjeshtë

<i>Njëjës</i>	<i>u</i> qëndrova <i>ti</i> qëndrove <i>ai</i> qëndroi
<i>Shumës</i>	<i>na</i> qëndruam <i>ju</i> qëndruat <i>ata</i> qëndruan

Si *qëndronj* zgjedhohen shumë folje të zgjedhimit të parë: (*shkonj*) *shkova*, *shkove*, *shkoi*, *shkuam*, *shkuat*, *shkuan*; (*kërkonj*) *kërkova*, *kërkove*, *kërkoi*, *kërkuam*, *kërkuat*, *kërkuan*, etj.

Edhe:

Folja lanj

<i>Njëjës</i>	<i>Shumës</i>
<i>u</i> lajta	<i>na</i> lajtëm
<i>ti</i> lajte	<i>ju</i> lajtët
<i>ai</i> lajti	<i>ata</i> lajtën

Si *lanj* zgjedhohen shumë folje të zgjedhimit të parë : (*shkruanj*) *shkruajta*, *shkruajte*, *shkruajti*, *shkruajtëm*, *shkruatët*, *shkruajtën*; (*rrëfyenj*) *rrëfyejta*, *rrëfyejte*, *rrëfyejti*, *rrëfyejtëm*, *rrëfyejtët*, *rrëfyejtën*, etj.

Edhe:

Folja bën

<i>Njëjës</i>	<i>Shumës</i>
<i>u</i> bëra	<i>na</i> bëmë
<i>ti</i> bëre	<i>ju</i> bëtë
<i>ai</i> bëri	<i>ata</i> bënë

Folje të parregullta në *kohën e kryer të thjeshtë*:-

- "da(lë)nj " : *dolla*, *dolle*, *dolli*, *dollëm*, *dllët*, *dollën*.

- "vinj" : (*je*)*erdha*, (*j*)*erdhe*, (*j*)*erdhi*, (*j*)*erdhëm*, (*j*)*erdhët*, (*j*)*erdhën*.

ZGJEDHIMI I DYTË

Folja shkul

Mënyra dëftore
Koha e kryer e thjeshtë

<i>Njëjës</i>	<i>u</i> shkula <i>ti</i> shkule <i>ai</i> shkuli
<i>Shumës</i>	<i>na</i> shkulëm <i>ju</i> shkulët <i>ata</i> shkulën

Si **shkul** zgjedhohen thuajse të gjitha foljet e zgjedhimit të dytë: (*hap*) *hapa*, *hape*, *hapi*, *hapëm*, *hapët*, *hapën*; (*përpjek*) *përpoka*, *përpoke*, *përpoki*, *përpqmëm*, *përpqët*, *përpqëm*; (*sos*) *sosa*, *sose*, *sosi*, *sosëm*, *sosët*, *sosën*; etj.

Folja **njoh**: *njoha*, *njohe*, *njohu*, *njhëm*, *njhët*, *njhën*.

Edhe:

Folja shkas

<i>Njëjës</i>	<i>Shumës</i>
<i>u</i> shkava	<i>na</i> shkamë
<i>ti</i> shkave	<i>ju</i> shkatë
<i>ai</i> shkau	<i>ata</i> shkanë

Si **shkas** zgjedhohen “*vras*”, “*ngas*”, e tjera.

Folje të parregullta në *kohën e kryer të thjeshtë* :

- **flas**: *folia*, *fole*, *foli*, *folëm*, *folët*, *folën*.
- **jap**: *dhashë*, *dhe*, *dha*, *dhamë*, *dhatë*, *dhanë*.
- **marr**: *mora*, *more*, *mori*, *morëm*, *morët*, *morën*;
edhe: *mora*, *more*, *mori*, *muar(t)ëm*, *muar(t)ët*, *muar(t)ën*.
- **mbjedh**: *mbjodha*, *mbjodhe*, *mbjodhi*, *mbjodhëm*, *mbjodhët*, *mbjodhën*.
- **rrhjedh**: *rrodha*, *rrodhe*, *rrodi*, *rrodhëm*, *rrodhët*, *rrodhën*.
- **shoh**: *pashë*, *pe*, *pa*, *pamë*, *patë*, *panë*.
- **thom**: *thashë*, *the*, *tha*, *thamë*, *thatë*, *thanë*.
- **vdes**: *vdiqa*, *vdiqe*, *vdiq*, *vdiqëm*, *vdiqët*, *vdiqën*.

ZGJEDHIMI I TRETË

Folja zë

Mënyra dëftore
Koha e kryer e thjeshtë

<i>Njëjës</i>	<i>u</i> zura
	<i>ti</i> zure
	<i>ai</i> zuri
<i>Shumës</i>	<i>na</i> zumë
	<i>ju</i> zutë
	<i>ata</i> zunë

Si *zë* zgjedhohet folja *vë*: *vura*, *vure*, *vuri*, *vumë*, *vutë*, *vunë*.

Edhe:

Folja di

<i>Njëjës</i>	<i>Shumës</i>
<i>u</i> dijta	<i>na</i> dijtëm
<i>ti</i> dijte	<i>ju</i> dijtët
<i>ai</i> dijti	<i>ata</i> dijtën

Si *di* zgjedhohet *rri*: *rrijta*, *rrijte*, *rrijti*, *rrijtëm*, *rrijtët*, *rrijtën*.

Folja *fle* bën kështu: *flepja*, *flepje*, *flepji*, *flepjtëm*, *flepjtët*, *flepjtën*.

Folje të parregullta në *kohën e kryer të thjeshtë*:

- *bie*: *rashë*, *re*, *ra*, *ramë*, *ratë*, *ranë*.
- *bie*: *prura*, *prure*, *pruri*, *prumë*, *prutë*, *prunë*.
- *dua*: *dasha*, *deshe*, *deshi*, *deshëm*, *deshët*, *deshën*.
- *ha*: *hëngra*, *hëngre*, *hëngri*, *hëngrëm*, *hëngrët*, *hëngrën*.
- *lë*: *lashë*, *le*, *la*, *lamë*, *latë*, *lanë*.
- *pi*: *piva*, *pive*, *piu*, *pimë*, *pitë*, *pinë*.

Ushtrime

Vër në *kohën e pakryer* këto folje:


- 1) lanj : - Lia laj xhubotin.
- 2) shkruanj : - Mara _____ një letër.
- 3) rrëfyenj : - Nona _____ një pullare.
- 4) kërkonj : - Ju, kë _____ këtu ?
- 5) shkul : - Era _____ fletët.
- 6) hap : - Ju, miq, ngë i _____ sytë !
- 7) hap : - Marku _____ dritaret.
- 8) përpjek : - Dje Vito _____ miqtë.
- 9) sos : - Festa _____ të hënë.
- 10) zë : - Festa _____ të diel.

Vër në *kohën e kryer të thjeshtë* këto folje:

- 1) Lia lajti xhubotin.
- 2) Mara _____ një letër.
- 3) Nona _____ një pullare.
- 4) Ju, kë _____ këtu ?
- 5) Era _____ fletët.
- 6) Ju, miq, ngë i _____ sytë !
- 7) Marku _____ dritaret
- 8) Dje Vito _____ miqtë.
- 9) Festa _____ të hënë.
- 10) Festa _____ të diel.

10

Te Sheshi



Nestër *ka shkonj* te Sheshi e *ka shoh* sa janë klishët e Horës.

Ka zë fill ka rrëzat e malit Picuta, ku ndodhet klishëza e Odhigjitrjes e *ka sos* te klisha e Shën Gjonit, përposh Sklicës. Në mes të panoramit *ka sodis* përparrë meje kumbullunin e madh të Shën Mërisë Odhigjitrje te qaca e pak më atej kambanarin e hollë e të glatë të Shën Gjergjit.

Te ana e sipërme e kumbullunit të Shën Mërisë te qaca, *ka vërrenj* façatën e bukur me shkallunerën e gjerë të klishës së Shën Vtitit, e pak më lart klishën e Patrevet.

Te ana e poshtme e kumbullunit të Shën Merisë *ka përseks* në mes të shpivet kambanarin e shkurtur, me majën guri të gjallë, të Shën Mitrit e, pak më atej, *ka gjenj* kambanarin e vogël të Shën Mërisë së Rruzarit. Pra, *ka prior* sytë drejt klishës së Shën Kollit e, më tek e shtrëmbra, drejt klishës së Shën Gjonit.

Kështu *ka njoh* ka Sheshi glithë klishët e Horës.

Vërejtje

“*ka shkonj, ka shoh, ka zë, ka sos, ka sodis, ka vërrenj, ka përseks, ka gjenj, ka prior, ka njoh*”, janë folje të tre zgjedhimevet vënë në *kohën e ardhshme* arbëreshe. Arbërisht, si dimë, ndodhet edhe forma: “*do shkonj, do shoh, do zë, ...*

Mënyra dëftore
Koha e ardhshme

ZGJEDHIMI I PARË

Folja shkonj

Shumës

u ka shkonj
ti ka shkosh
ai ka shkonjë

na ka shkojëm
ju ka shkoni
ata ka shkojën

Njëjës

ZGJEDHIMI I DYTË

Folja sos

Shumës

u ka sos
ti ka sosësh
ai ka sosënj

na ka sosjëm
ju ka sosni
ata ka sosjën

Njëjës

ZGJEDHIMI I TRETË

Folja zë

Shumës

u ka zë
ti ka zësh
ai ka zënj

na ka zëmë
ju ka zëni
ata ka zënë

Njëjës

Ushtrime

Vër në kohën e ardhshme këto folje:

- 1) *shkonj* : - Nestër _____ te nona.
- 2) *pres* : - Na _____ dy dërrasa me serrën.
- 3) *lë* : - Marë, lulet te bari _____ i _____ të rriten.
- 4) *shes* : - Marku _____ më _____ bicikletën e tij.
- 5) *ndërronj* : - Sara _____ sh(të)pi.
- 6) *lanj* : - Lia _____ mbaracet.
- 7) *stis* : - Mas Gjergji _____ një sh(të)pi te Fusha.
- 8) *zbyll* : - E jëma e Maries _____ një putigë te Gamili.
- 9) *pres* : Kele, ku _____ i _____ miket ?
- 10) *pres* : Marë, Sarë e Lia, ku _____ e _____ Kelen ?



Kazallot

Kazallot i *kam klënë* shumë herë. Kur isha i vogël ngë i *kisha klënë* kurrë.

Noni më thëshëj se Kazallot *kish pasur* një herë një vreshtë, çë ia *kish lënë* i jati.

“Kazalloti” *ka klënë* një nga ëmret më antikë të Horës; thomse ia *kishën vënë* litinjtë, më parë se Arbëreshët t’ë thërrisjën me emrin “Hora”.

Ka shpitë e Kazallotit *kam parë* se ngë duket gjithë panorami i Horës, ma duken mirë malet Kumeta e Picuta e duket liqeni.

Kur *kam pasur* qëro, *kam vatur* Kazallot me bicikletën, bashkë me miqtë e miket; atje *kemi qëndruar*, *kemi ngrënë* paninet, çë na *kanë përgatitur* mëmat, e *kemi shkuar* orët tue luar te bari.



Vërejtje

- A) *kam klënë*, *ka klënë*, *kam parë*, *kam pasur*, *kam vatur*, *kemi qëndruar*, *kemi ngrënë*, *kanë përgatitur*, *kemi shkuar* janë forma të kohës së kryer të dëftores.
- B) *kisha klënë*, *kish pasur*, *kish lënë*, *kishën vënë* janë forma të kohës së kryer të plotë të dëftores.

Menyra dëftore

Koha e kryer

Koha e kryer e plotë

Folja	kam	jam	shkonj	kam	jam	shkonj
<i>Njëjes</i>	<i>u</i> kam pasur	kam klënë	kam shkuar	kisha pasur	kisha klënë	kisha shkuar
	<i>ti</i> ke pasur	ke klënë	ke shkuar	kishe pasur	kishe klënë	kishe shkuar
	<i>ai</i> ka pasur	ka klënë	ka shkuar	kish pasur	kish klënë	kish shkuar
<i>Shumës</i>	<i>na</i> kemi pasur	kemi klënë	kemi shkuar	kishëm pasur	kishëm klënë	kishëm shkuar
	<i>ju</i> kini pasur	kini klënë	kini shkuar	kishët pasur	kishët klënë	kishët shkuar
	<i>ata</i> kanë pasur	kanë klënë	kanë shkuar	kishën pasur	kishën klënë	kishën shkuar

Koha e kryer formohet duke i shtuar *kohës së tashme* të foljes ndihmëse *kam, pjesoren* e foljeve.

Për shembull

kam + pjesoria e foljes

kam (pasur)
jam (klënë)
qëndronj (qëndruar)
përgatit (përgatitur)
ha (ngrënë)
vete (vatur)

kam pasur, ...
kam klënë, ...
kam qëndruar, ...
kam përgatitur, ...
kam ngrënë, ...
kam vatur, ...

Koha e kryer e plotë formohet duke i shtuar *kohës së pakryer* të foljes ndihmëse *kam, pjesoren* e foljeve.

Për shembull:

kisha + pjesoria e foljes

kam (pasur)
jam (klënë)
qëndronj (qëndruar)
përgatit (përgatitur)
ha (ngrënë)
vete (vatur)

kisha pasur, ...
kisha klënë, ...
kisha qëndruar, ...
kisha përgatitur, ...
kisha ngrënë, ...
kisha vatur, ...

Ushtrime

a) Vér në *kohën e kryer* foljet me *pjesoren* ndër kllapa.

- 1) *shkonj* (shkuar): - Mara ngë ka shkuar te nona.
- 2) *thom* (thënë) : - Lia, i _____ gjë Markut ?
- 3) *vë* (vënë) : - Vito, ia _____ vajt te motori ?
- 4) *jap* (dhënë) : - Djemtë ngë ia _____ dhuratat vajzavet.
- 5) *shoh* (parë) : - Na ngë _____ festa kështu të bukura !

b) Vér në *kohën e kryer* të *plotë* foljet me *pjesoren* ndër kllapa.

- 1) *lanj* (larë) : - Këtë xhubot Sara e kish larë vjet.
- 2) *ha* (ngrënë) : - Djemtë i thanë nonës se ngë _____ .
- 3) *pres* (pritur) : - Marë, te çili bar ti më _____ ?
- 4) *pres* (prerë) : - Vestën kalivari ia _____ u Maries !
- 5) *shes* (shitur) : - Makinën na e _____ vjet.

12

Te liqeni i Horës



Liqeni i Horës së Arbëreshëvet *ka ketë klënë* te vitet '20 një nga liqenet më të mëdhenj të Sicilljes, përçë liqenet ahierna te Siçillja ishën pak. Edhe shëbërtirët të ngrejën dighën *ka kenë klënë* të forta, përçë digha ë bërë gjithë me gurë të gjallë katërkëndëshë.

Arbëreshët e Horës e të Sendastinës *ka kenë pasur* shëbërtirë pér ca vjet, si pér një parë vjet e patën kur te vitet 1968/’69 u përforcua digha, çë terrmeti kish dëmtuar një skajë.

Liqeni *ka ketë zënë* fill të mbjidhëj ujët e lumiit “Beliçe”, të “Drinjës” e të tjerëvet lume te Horës, çë nga viti 1923, data e shkruar e të lerit të tij; *ka ketë sosur* t’ë mblidhëj te viti 1968 pér termetin e *ka ketë shkuar* pameta te emri i liqenevet të gjallë kur ndërtuan dighën te viti 1969/70: njera më sot ngë u ka mbrazur më.

Ka liqeni duket gjithë kurora e malevet çë rrrethojën Horën: kushedi sa herë arbëreshët e vitevet '20 *ka e kenë parë* këtë panoram !

Vërejtje

“*ka ketë klënë, ka kenë klënë, ka kenë pasur,*
ka ketë zënë, ka ketë sosur, ka ketë shkuar, ka kenë parë”
 janë folje të të tre zgjedhimevet vënë në
kohën e ardhshme të përparme arbëreshe.

Arbërisht, si dimë, ndodhet edhe forma:

